

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5803
E hënë, 17 qershor 2019
çmimi 0.40 €

Përrurohet shtatorja e heroit Shkëlzen Haradinaj

FAQE 3



PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS (PDK) KA MBAJTUR TË DIELËN KONVENTËN E NËNTË ZGJEDHORE NË TË CILËN KA ZGJEDHUR KRYETARIN DHE STRUKTURAT E REJA DREJTUESE

FAQE 4-5

Veseli rizgjedhet kryetar i PDK-së, prezantohet edhe si kryeministër i ardhshëm



Kadri Veseli është rizgjedhur edhe për një mandat në krye të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK). Të gjithë delegatët e Konventës së Nëntë Zgjedhore të PDK-së në mënyrë të hapur ia kanë dhënë besimin Veselit për ta drejtuar këtë parti edhe për

katër vjet të ardhshëm. Pas marrjes së besimit, Veseli është zotuar se nuk do të lejojë askënd që ta pengojë Kosovën që të ecë përpara, duke kërkuar nga delegatët që vazhdimisht të kërkojnë përgjegjësi dhe qartësi nga ai. Veseli ka deklaruar se nuk do

të lejojë të ketë dilema për të ardhmen e vendit. Ndërsa nënkryetari i PDK-së, Hajredin Kuçi, i cili ka prezantuar kandidaturën e Veselit për kryetar, ka thënë se lideri i PDK-së do të jetë kryeministër i ardhshëm i Kosovës

Bizneset kërkojnë kthimin e bordit për shqyrtimin e ankesave

Përfaqësuesit e asociacioneve të bizneseve, Astrit Panxha dhe Skënder Krasniqi, e shohin të nevojshëm rifunksionalizimin e bordit për shqyrtimin e ankesave që ka të bëjë me kontestet e bizneseve. Edhe prodhuesi vendor Burim Piraj ka theksuar rëndësinë e funksionalizimit të këtij bordi. Ndërkaq këshilltari për çështje ekonomike i kryeministrit, Haki Shatri, e ka quajtur vendim të gabuar shuarjen e bordit për shqyrtimin e ankesave



Zgjedhjet në LDK po përcillen me pakënaqësi

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

TA ZGJIDHIM KRIZËN PA KËRKUAR 'VRANITZKY'-N

F. 11

Koço KOKËDHIMA



PJESA E DYTË E TESTIT TË MATURËS FILLON MË 19 QERSHOR

F. 7

ARSIM BAJRAMI HEQ DORË NGA STRUKTURAT PARTIAKE TË PDK-së

F. 5

EKONOMI

PRODUKTET AMERIKANE PËRMES KOSOVËS NË EVROPË

F. 9



KULTURË

HAZIRI IA DORËZON EDI SHUKRIUT ÇMIMIN LETRAR 'BEQIR MUSLIU'

F. 10

SPORT

OSMANI: NUK MUNDA TA REFUZOJ OFERTËN E LLAPIT

F. 18



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Henze: Populli vendos se a do ta mbajë këtë qeveri

BERLIN, 16 QERSHOR - Këshilltari ekonomik i Grupit Parlamentar CDU në Bundestagun gjerman, Martin Henze, përmes një postimi në rrjetet sociale, iu referohet përgjimeve të Bildit dhe e konsideron qeverinë shqiptare si e ashtuquajtura "qeveria e mafias Rama", e cila, sipas tij, nuk ka përmbushur asnjë pikë të vetme për hapjen e negociatave me BE-në.

Henze thotë se është populli ai që duhet ta bëjë diferencën dhe të zgjedhë mes saj e forcave demokratike të opozitës. "E cilë-

suar nga prestigjiozja gjermane 'BILD' si 'qeveria e mafias Rama, mban përgjegjësi jo vetëm për gjendjen e keqe ekonomike, për shkatërrimin e sistemit gjyqësor dhe të parlamentit, për korrupsionin në administratën publike, varfërinë dhe largimin masiv të të rinjve shqiptarë, shkatërrimin e familjeve shqiptare, manipulimin në zgjedhjet e fundit parlamentare së bashku me mafien por, gjithashtu, është politikisht përgjegjëse sepse nuk ka përmbushur asnjë pikë të vetme për hapjen e bisedimeve me BE-në",

ka thënë Henze.

Ai ka shtuar se e ashtuquajtura "qeveria e mafias Rama" është përgjegjëse për këtë. "Tani është koha që populli shqiptar të vendosë: a dëshiron ta mbajë ende në këmbë këtë qeveri, mafien, urinë, varfërinë, korrupsionin, antidemokracinë, prostitucionin, trafikimin e drogës dhe largimin masiv apo dëshiron një të ardhme në Bashkimin Evropian?"

Nëse populli dëshiron të ardhme në BE, duhet të bëjë një angazhim politik me forcat demokratike të opozitës", ka thënë Henze.



Rama: Më 30 qershor vendoset për Shqipërinë e 30 vjetëve të ardhshëm

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë se më 30 qershor nuk do vendoset thjesht se kush do t'i drejtojë bashkitë për katër vjetët e ardhshëm, por do të vendoset se cila do të jetë Shqipëria e 30 vjetëve të ardhshëm



TI RANË, 16 QERSHOR - "Më 30 qershor nuk do të vendoset thjesht kush do t'i drejtojë bashkitë për katër vjetët e ardhshëm, por se cila do të jetë Shqipëria e 30 vjetëve të ardhshëm", deklaroi të dielën nga Maliqi, kryeministri Edi Rama, gjatë takimit elektorale ku dhe u prezantua kandidati i PS-së për kryetar bashkie, Gëzim Topçiu. "Në këto zgjedhje punët u ngatërruan pak sepse këto janë zgjedhje vendore, por për shkak të kundërshtarëve tanë janë kthyer në zgjedhje që janë, njëkohësisht, edhe politike, edhe qytetare, edhe atdhetare. Më 30 qershor nuk do të vendoset thjesht se kush do t'i drejtojë bashkitë për katër vjetët e ardhshëm por, po ashtu, do të vendoset se cila do të jetë Shqipëria e 30 vjetëve të

ardhshëm. A do të jetë Shqipëria e 30 vjetëve të ardhshme ajo e këtyre 30 vjetëve të shkuara kur politikanët sa herë kanë dashur, kanë bërë çfarë kanë dashur me Kushtetutën dhe me ligjin, kur politikanët kanë qëndruar gjithmonë mbi ligjin, kur politikanët u kanë dhënë vetes të drejta të cilat nuk u njihen qytetarëve sepse ligji nuk ua jep ama ata kanë synuar dhe synojnë që të ngrihen mbi ligjin dhe jo vetëm kaq, por duke sharë, kërcënuar, mallkuar, turbulluar, të marrin peng një popull të tërë, procesin demokratik në Shqipëri, të marrin peng zgjedhjet për të marrë peng vetë Shqipërinë", tha Rama.

Në fjalën e tij, kreu i ekzekutivit solli në vëmendje të njëjtën sjellje të opozitës dy vjet më

parë kur iki nga parlamenti dhe deklaroi se nuk do të hyjë në zgjedhje dhe nuk do të lejohet të bëheshin zgjedhje, por se qëllimi ishte ta merrte peng vetingun. "Ikën nga parlamenti për të mos votuar Ligjin e vetingut dhe për të penguar drejtësinë. Sot kanë ikur nga parlamenti dhe zgjedhjet për ta penguar Shqipërinë sepse vetingun nuk e penguan dot. Vetingu ka filluar, po vazhdon për ditë duke pastruar ditaditës pallatin e drejtësisë nga

gjykatës dhe prokurorë që, falë lidhjes së tyre me politikanët dhe marrëveshjes në mëkat me politikanët, kanë mbajtur peng drejtësinë 30 vjet", u shpreh kryeministri.

Ndërkaq kreu i PD-së, Lulzim Basha, tha se Shqipëria nuk do të digjet, por opozita nuk trembet, si një reagim për deklaratat e kryeministrit Rama gjatë fushatës së tij elektorale kryesisht në qarkun e Korçës. "Edi Rama ka javë që bredh nëpër Shqipëri duke ngjallur panik e

duke kërcënuar sa me djegie të vendit dhe sa me burgosje të të gjithë opozitës. Kam një lajm të keq për të: Shqipëria nuk do të digjet dhe opozita nuk trembet", tha Basha. Sipas tij, muajt e fundit Rama ka ndaluar dhe arrestuar qindra qytetarë dhe opozitarë, së fundi drejtuesit e PD-së së Elbasanit dhe Librazhdit dhe të gjithë e kanë parë se askush nuk trembet nga kërcënimet dhe veprimet e tij perverse.

Kryetari demokrat shton se shqiptarët po ia provojnë atij përditë kudo nëpër Shqipëri, të cilën ai tani e viziton nën mbrojtjen e qindra forcave policore, sikur të jetë duke ecur përmes një territori armik dhe jo vendor të tij.

Në deklaratën për shtyp, Basha bën të ditur se fundi i tij dhe i veglave të tij qorre në kuvend, qeveri, polici, prokurori, është i pashmangshëm! "Ai e di këtë, prandaj është shpërfytyruar dhe po bën atë që bëjnë kriminelët kur rrethohen: po kërcënon se do ta shpërthejë bombën e do t'i hedhë të gjithë në erë", tha Basha.

LSDM-ja vendos për fatin e qeverisë së Zaevit

SHKUP, 16 QERSHOR - Partia më e madhe në pushtet, LSDM, të dielën në Ohër ka mbledhur Këshillin Qendror, ku është diskutuar për vendimet që do të pasojnë pas njoftimit se data për negociatave me BE-në mund të ndahet gjatë muajve të vjeshtës. Sipas disa burimeve, tani më nga loja është përjashtuar opsioni i organizimit të zgjedhjeve të parakohshme për shkak se, megjithatë, ndonëse jo në qer-

shor, por brenda vitit, Maqedonia e Veriut do ta marrë datën për fillim të bisedimeve me BE-në. Në kombinim vazhdojnë të mbeten disa opsione të tjera nga ata që ka paralajmëruar kreu i kësaj partie, e të cilat i përsëriti edhe pas takimit me kancelaren gjermane Angela Merkel. Në mbledhjen e së dielës mund të vendoset për rekonstruim të qeverisë, por edhe për kthim të

mandatit të vetë kryeministrit dhe zgjedhje të një qeverie krejtësisht të re. Gjithashtu, të hapur mbeten edhe mundësitë që Zaevi të rikandidojë për mandat të ri, ose në vend të tij të nominohet një kandidat tjetër nga po e njëjta parti.

Gjatë ditëve në vazhdim mund të vendoset që përgjegjësi të kërkohet edhe vetëm për zvarritjen e procesit integruar si dhe nga disa funksionarë të caktuar



të cilët nuk kanë dhënë rezultate të pritura në punën e tyre. Rikonstruimi i qeverisë, i cili tanimë është më se i sigurt, nuk dihet vetëm nëse do të preket një

pjesë të ministrave apo të gjithë, si dhe nuk dihet nëse ndryshimet do të pasohen edhe nga partnerët e tjerë të koalicionit qeveritar.

Haradinaj thotë se dialogu Kosovë - Serbi është i nevojshëm

Vazhdimi i procesit të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë është i nevojshëm. Kështu ka deklaruar kryeministri Ramush Haradinaj të dielën në përrurimin e shtatores së Shkëlzen Haradinajt dhe obeliskut të 183 dëshmorëve të Pejës. Ai ka thënë se nga dialogu Kosova synon njohje reciproke, por assesi nuk e vë në dyshim statusin e zgjidhur më 17 shkurt të 2008-s. Sipas Haradinajt, Kosova dhe Serbia duhet ta zgjidhin vetëm çështjen e njohjes së ndërsjellë. Ai ka thënë se ka përfunduar koha që të kërkohet paqe dhe stabilitet në Ballkan në dëm të Republikës së Kosovës



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 16 QERSHOR - Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, ka thënë të dielën se Kosova është e interesuar që të jetojë në fqinjësi të mirë edhe me Serbinë, por jo duke biseduar për statusin që është mbyllur në vitin 1999 dhe 2008. Ai ka vlerësuar se vazhdimi i procesit të dialogut në mes të dy vendeve është i nevojshëm. "Ne jemi të interesuar për fqinjësi të mirë edhe me Serbinë. Pra, jemi për fqinjësi të mirë, por mos ta njohësh ekzistencën e Kosovës dhe t'i kërkosh tregun duhet harruar këtë. Edhe dialogu për të cilin të gjithë jemi të interesuar është i nevojshëm. Kemi nevojë të ecim përpara dhe të merremi vesh, mirëpo duhet të nënshkruhet një marrëveshje kornizë për çka të merremi vesh. E ajo për çka duhet të merremi vesh nuk është statusi i Kosovës sepse është zgjidhur në vitin 1999 dhe më 17 shkurt 2008. Nuk është territori që e kemi në hartë e as kufijtë sepse kemi marrëveshje për menaxhimin e kufijve me

Serbinë të nënshkruar në Bruksel. Pra, nuk ka kontest kufitar në mes të Kosovës dhe Serbisë", ka deklaruar kryeministri Haradinaj në ceremoninë e përrurimit të shtatores së Shkëlzen Haradinajt dhe obeliskut të 183 dëshmorëve të Pejës.

Sipas kryeministrit Haradinaj, ka përfunduar koha që dikush të kërkojë paqe dhe stabilitet në Ballkanin Perëndimor në dëm të Republikës së Kosovës. "Nuk hezitojmë të shkojmë kah paqja në Ballkan dhe t'i forcojmë paqen dhe lirinë, por mos të pretë askush më se do të ndërtojmë çfarëdo paqe dhe përparimi në Ballkan në dëm të Kosovës dhe shqiptarëve. Ajo kohë ka përfunduar. Tani është koha e respektit, e njohjes së ndërsjellë. Ajo që ka mbetur për t'u zgjidhur është marrëdhënia bilaterale, a duam të njihemi dhe a duam të jetojmë me njohje dhe respektim të ndërsjellë", është shprehur Haradinaj. Ai ka shprehur përkushtimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për t'u bërë pjesë e Bashkimit Evropian dhe NATO-s. Sipas Haradinajt, Kosovës

nuk i duhet liria e izoluar. "Nuk dëshirojmë liri që e izolon popullin tonë. Kemi kërkuar lirinë tonë për të qenë vetë të lirë, por edhe për t'iu bashkuar popujve të lirë. Janë popujt euroatlantikë, është Evropa në të cilën synojmë të anëtarësohemi, pra të bëhemi pjesë e BE-së dhe NATO-s që i prinë Amerika. Me lirinë tonë dëshirojmë të bashkohemi me popujt e lirë. Nuk na duhet liria në izolim", ka theksuar ai.

Më tutje, Haradinaj ka folur edhe për marrëdhëniet me Maqedoninë e Veriut dhe me Malin e Zi, me ç'rast ka falënderuar lidhshiptin e tyre për gatishmërinë e zgjidhjes së çështjeve të hapura. "Para pakë ditëve kemi përruruar autoritë që na lidh me Maqedoninë e Veriut, ku kemi treguar se sa shumë tash mund

të lidhemi me popullin e Maqedonisë së Veriut. Jemi të interesuar t'i thellojmë marrëdhëniet edhe me shtetin e Malit të Zi. Falënderoj lidhshiptin e tij për gatishmërinë për ta zgjidhur çdo çështje që ka mbetur e pambyllur me Kosovën, me hap vendkalime të reja në kufij, në Çakorr dhe Kullë, me krijë infrastrukturë të mirë dhe bashkëpunim mes vete si dy popuj që i takojmë së njëjtës familje. Pra, do t'i takojmë familjes evropiane dhe NATO-s. Mali i Zi veç është në NATO, po edhe ne synojmë të jemi atje", është shprehur kryeministri Haradinaj, duke shtuar se Kosova nuk do të heqë dorë nga drejta e saj dhe nuk do t'i tradhetojë miqtë dhe aleatët. "Këtë e kemi traditë dhe do ta ruajmë", ka theksuar ai.

Ndërsa duke folur për marrëd-

hëniet dhe bashkëpunimin me Shqipërinë, kryeministri Haradinaj ka thënë se do të punohet për heqjen e të gjitha pengesave në mes të dy vendeve. Madje ai ka kërkuar të hiqet edhe tarifa prej pesë eurosh që është vendosur nga autoritetet e shtetit shqiptar në autostradën e kombit. "Dëshirojmë të kemi ekonomi dhe tregti të lirë. Jemi të hapur për tregti të lirë pa tarifa dhe kurrë nuk kemi me i qit tarifa Shqipërisë. Fjalë të rrugëve janë ato që dikush thotë se i qesim tarifa ose i ndalim autobusët e Shqipërisë. Jo, ne kemi pritur gjatë për të shkuar e për të ardhur. Do t'i lehtësojmë edhe barrierat që ekzistojnë sot. Mirë është ta heqë edhe atë taksë prej pesë eurosh që e ka vënë në autostradë, se gjë nuk po i duhet", ka deklaruar kryeministri Haradinaj.

Përrurohet shtatorja e heroit Shkëlzen Haradinaj dhe obelisku i 183 dëshmorëve të Pejës

Pejë, 16 qershor (ER) - Në Pejë e Haxhi Zekës dhe të shumë patriotëve që i kanë shërbyer atdheut ndër breza të dielën është përruruar shtatorja e heroit të kombit, gjeneral-major Shkëlzen Haradinaj dhe obelisku i 183 dëshmorëve nga Komuna e Pejës, në nderim të veprës heroike dhe sakrificës sublime për liri. Me këtë rast kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, ka thënë se me përrurimin e kësaj shtatoreje dhe obeliskut janë nderuar të gjithë qytetarët e kësaj ane dhe të gjithë ata që me rezistencë paqësore luftuan për të drejtën tonë. "Falënderim për të gjithë qytetarët, përfaqë-



suesit e institucioneve, familjarët e dëshmorëve dhe martirëve, bacën Rifat e Halit, ish-presidentin e Kroacisë, Stipe Mesic, që sot u bënë bashkë, në kujtim e nderim të dëshmorëve dhe 20-vjetorit të çlirimit të Pejës. Lavdi e përjetshme për të gjithë të rënë për liri!", ka deklaruar Haradinaj.

Ndërkaq kryetari i Komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri, ka thënë se përmendorja e Shkëlzenit dhe obelisku i dëshmorëve të Pejës janë jo vetëm obligim, por nder për qytetin dhe për gjeneratat që vijnë, janë obligim që të punohet për ndërtimin e shtetit të Kosovës,

për një jetë më të mirë. Një fjalë rasti e ka mbajtur edhe kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, i cili ka thënë se obelisku me emrat e heronjve dhe dëshmorëve të kombit, si dhe shtatorja e heroit Shkëlzen Haradinaj, të vendosura të dielën në Pejë, për ta nderuar 20-vjetorin e çlirimit, do të na kujtojnë në vazhdimësi rrugën se si kemi ardhur deri te 16 qershori i vitit 1999. I pranishëm në përrurimin e kësaj shtatoreje ishte edhe ish-presidenti i Kroacisë, Stipe Mesic, Rifat Jashari dhe personalitete nga jeta politike e Maqedonisë.

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka mbajtur të dielën Konventën e Nëntë Zgjedhore në të cilën ka zgjedh

Veseli rizgjedhet kryetar i PDK-së, preza



Kadri Veseli është rizgjedhur edhe për një mandat në krye të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK). Të gjithë delegatët e Konventës së Nëntë Zgjedhore të PDK-së në mënyrë të hapur ia kanë dhënë besimin Veselit për ta drejtuar këtë parti edhe për katër vjet të ardhshëm. Me të marrë besimin, Veseli është zotuar se nuk do të lejojë askënd që ta pengojë Kosovën që të ecë përpara, duke kërkuar nga delegatët që vazhdimisht të kërkojnë përgjegjësi dhe qartësi nga ai. Veseli ka deklaruar se nuk do të lejojë që të ketë dilema për të ardhmen e vendit. Ndërsa nënkryetari i PDK-së, Hajredin Kuçi, i cili ka prezantuar kandidaturën e Veselit për kryetar, ka thënë se lideri i PDK-së do të jetë kryeministër i ardhshëm i Kosovës

**EPOKA
ERE** **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 16 QERSHOR - Në mënyrë unanime delegatët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Konventën e Nëntë Zgjedhore mbajtur të dielën kanë rizgjedhur Kadri Veselin kryetar të PDK-së edhe për katër vjet të tjera. Në fjalën përshëndetëse pas rizgjedhjes, lideri i PDK-së, Kadri Veseli, ka shprehur mirënjohjen për besimin që i dhanë për drejtimin e

partisë, duke thënë se këtë besim do ta shpërblejë me punë, përkushtim dhe përgjegjësi të lartë. "Delegatë të nderuar, ju sot më keni bërë nder. Unë e di, ju menjëherë kërkon përgjegjësi, kërkon leadership, kërkon vizion, kërkon që në PDK të mos ketë dilema, ose mos të ketë paqartësi, mos të ketë abuzime. Por të ketë drejtim të qartë për vendin, për partinë, për kombin, në mënyrë që të ecim përpara", ka thënë Veseli.

Lideri i PDK-së ka bërë me dije se të gjithë kanë dhënë shumë mund për të ardhur deri këtu, duke shtuar se për këtë arsye nuk do të lejojë askënd që ta pengojë Kosovën që të ecë përpara. "Ne nuk do të lejojmë që të ketë dilema, sot dy dekada mbrapa, se a do ta fitojmë lirinë, zhvillimin, perspektivën dhe të ardhmen tonë. Nuk do të lejoj askënd dhe me asgjë që atë që nuk është në interesin e kombin tonë dhe të qytetarëve. Nuk do të lejojmë askënd dhe

me asgjë që të na pengojë nga procesi për të ecur përpara. Ka vetëm një rrugë, ajo është e përgjegjësisë, e shansit të barabartë, por edhe e vizionit, i cili është vizion i qytetarëve tanë, është vizion i lirisë, dhe i marrjes së përgjegjësisë", është shprehur Veseli.

Para qindra delegatëve, Veseli është zotuar se do ta çojë në vend amanetin e gjithë atyre që ranë për liri. "Do të jem i pakompromis të çojmë atje ku duhet amanetin e gjithë atyre që kanë rënë në altarin e lirisë dhe, për më shumë, ta çojmë përpara dëshirën e gjeneratave të reja që po rriten sot, fëmijëve tanë. Kjo do të jetë politika dhe vizioni ynë. Përgjegjësi bashkërisht. Të ecim në këtë formë, t'i tregojmë edhe botës se çfarë bëri Kosova dhe si eci Kosova", është shprehur Veseli. Ai ka deklaruar se procesi i zgjedhjeve të brendshme të PDK-së ishte një garë e hapur, transparente dhe gjithëpërf-

shirëse. Sipas Veselit, opozita duhet ta marrë shembull PDK-në për organizimin e zgjedhjeve të brendshme. "Në të njëjtën kohë, edhe kolegëve tanë opozitarë t'ju japim shembull. Me vetë faktin se çfarë konvente kemi sot dhe procesin zgjedhor, jemi një shembull tipik i demokracisë në Republikën e Kosovës. Jemi krenarë për këtë dhe do të vazhdojmë edhe më fuqishëm", ka thënë Veseli.

Kuçi: Veseli do të jetë kryeministër i ardhshëm i Kosovës

Në emër të kryesisë së PDK-së kandidaturën e Kadri Veselit për kryetar të PDK-së e ka prezantuar nënkryetari i këtij subjekti politik, Hajredin Kuçi. Para delegatëve, ai ka treguar se Veseli gjatë këtyre tre vjetëve ka dëshmuar se meriton të jetë edhe për një mandat në krye të

ur kryetarin dhe strukturat e reja drejtuese

ntohet edhe si kryeministër i ardhshëm



thosha, ka parë edhe në kohën kur ka pasur gaz lotsjellës në Kuvend, ka ruajtur qetësinë, guxim dhe menaxhimin adekuat të institucionit më të lartë të vendit. Si udhëheqës i koalicionit qeverisës ka meritat kryesore për funksionimin dhe mbajtjen gjallë të këtij koalicioni. Nuk ka qenë e lehtë që z. Veseli shpeshherë të bëjë kompromise, toleranca edhe në mbajtjen e koalicionit qeverisës", është shprehur Kuçi. Në fund të adresimit të tij, Kuçi u ka thënë delegatëve të PDK-së se duke votuar Veselin po votojnë kryeministrin e ardhshëm të Kosovës. "Unë e di se duke e votuar sot z. Veseli do të garantoni një leadership të fortë të PDK-së për proceset e ardhshme. Ju të nderuar delegatë e keni fjalën kryesore, por jam i bindur se zgjedhja e Kadri Veselit kryetar i PDK-së do ta ruajë dhe forcojë stabilitetin e PDK-së, por edhe stabilitetin e vendit tonë, Kosovës. Do t'i japim shtytje edhe më të madhe 'Dekadës së Re', që mban firmën, emrin dhe vulën e tij. Krejt në fund më lejoni të them se duke e votuar Kadri Veselin, të gjithë ne po e votojmë kryeministrin e ardhshëm të Kosovës, i cili do të jetë nga PDK-ja", është shprehur Kuçi. Ndërsa lideri i PDK-së, Kadri Veseli, në hapje të Konventës së Nëntë Zgjedhore ka thënë se PDK-ja është gjithmonë e përgatitur, e reformuar e me energji të reja për t'u shërbyer qytetarëve dhe për ta forcuar Republikën e Kosovës. "Sot Partia Demokratike e Kosovës është më e madhe, më e fuqishme, më e konsoliduar, më e gatshme për të marrë mbi vete rolin që i takon, rolin e partisë që iu prinë ndryshimeve dhe zhvillimit të

Arsim Bajrami heq dorë nga strukturat partiake të PDK-së



PRISHTINË, 16 QERSHOR (ER) - Arsim Bajrami ka bërë me dije se më nuk do të jetë pjesë e angazhimit politik në Partinë Demokratike të Kosovës (PDK) në çfarëdo pozite në këtë subjekt politik. Ai përmes një njoftimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar të dielën se do të vazhdojë të mbetet anëtar i thjeshtë dhe votues i PDK-së. Bajrami ka treguar se për largimin e tij nga funksionet e

larta partiake ka njoftuar përmes një letre edhe kryetarin e partisë, Kadri Veselin. "Dëshiroj që edhe përmes këtij rrjeti social t'i njoftoj me falënderim dhe mirënjohje anëtarët, simpatizantët, votuesit dhe strukturat e Partisë Demokratike të Kosovës, për vendimin tim për të hequr dorë nga çfarëdo propozimi apo nominimi për t'u zgjedhur në strukturat partiake", ka shkruar Bajrami,

duke vlerësuar lart me mirënjohje, mbështetjen dhe besimin e anëtarëve, simpatizantëve dhe strukturave të leadershipit të Partisë Demokratike të Kosovës, për mbështetjen dhe besimin e rezervë për gati 20 vjet. "Si një ndër themeluesit e partisë më kanë besuar dhe zgjedhur në funksionet më të larta partiake, politike e institucionale. Konsideroj që tani, pas gati dy dekada, është e rrugës të ofroj edhe një kontribut modest me shembullin personal, që angazhimi aktiv partiak dhe politik duhet ta ketë një fillim dhe fund të arsyeshëm dhe të dinjitetshëm, duke ofruar hapësirën e nevojshme për gjeneratat më të reja, ndërsa do të vazhdoj të mbetem anëtar i thjeshtë dhe votues i PDK-së dhe të ofrohem gjithnjë, me të gjitha kapacitetet, si zë i arsyes dhe këshillës e kritikës dashamirëse, të cilat jam përpjekur e angazhuar t'i promovoj, tash e gati dy dekada me radhë, në kuadër të Partisë Demokratike të Kosovës", ka thënë Bajrami. Ai e ka uruar PDK-në që të zhvillojë një proces zgjedhor kredibil, legjitim dhe në frymën demokratike.

PDK-së. "Gjatë tre vjetëve të shkuara z. Veseli ka arsyetuar plotësisht besimin e dhënë nga delegatët e PDK-së dhe qytetarët e Republikës së Kosovës. Dhe sot mund të them ballëhapur që mund ta kërkojmë ribesimin për z. Veseli, pasi është treguar i denjë për ta drejtuar PDK-në dhe për ta çuar përpara trashëgiminë politike që ka pasur PDK-ja. Me angazhimin dhe përkushtimin e tij vizionar, ai ka treguar se mund ta drejtojë PDK-në me vlera të mëdha kombëtare dhe politike. Ka treguar se kur janë në pyetje interesat e mëdha të vendit, ai sheh përtej egos së tij personale dhe interesave të ngushta politike të PDK-së", ka thënë Kuçi. Më tej, Kuçi ka vlerësuar se Veseli edhe si kryetar i Kuvendit dhe si lider i koalicionit qeverisës ka treguar qetësi dhe pjekuri politike. "Si kryetar i Kuvendit ka treguar një qetësi dhe pjekuri politike. Do të

vendit. Sot Partia Demokratike e Kosovës bën dallimin nga të tjerët. Sot Partia Demokratike e

Kosovës me punën tuaj dëshmon se është parti e qytetarëve, nga qytetarët dhe për qytetarët.

Ky është ligji suprem i partisë sonë. Është shpirti i platformës për 'Dekadën e Re'. Është kuptimi i vetëm për të cilin ekziston Partia Demokratike e Kosovës", ka thënë Veseli, duke shtuar se ky proces zgjedhor është meritë e secilit anëtar të PDK-së, secilës degë, nëndegë dhe seksioni. "Të nderuar delegatë, ne nuk jemi të përsosur, por jemi më të mirët. Ne nuk jemi të pagabueshëm, por kemi forcën për t'u përballur me gabimet dhe lëshimet tona. Ne kemi punuar shumë dhe kush punon, edhe gabon, por kur është në pyetje Kosova, ne nuk gabojmë kurrë", ka thënë Veseli.

Pas zgjedhjes së kryetarit, Konventa e Nëntë Zgjedhore e PDK-së i ka vazhduar punimet për ta zgjedhur Këshillin Drejtues, miratimin e programit politik të PDK-së, statutin e ri të partisë dhe, më pas, miratimin e deklaratës politike.



Shoqëria civile nuk e pranon ulësen në ekipin negociator



PRISHTINË, 16 QERSHOR - Duke konsideruar se janë të pabarabartë me anëtarët e tjerë të ekipit negociator të Kosovës në dialogun me Serbinë, pjesëtarët e shoqërisë civile kanë vendosur që të mos bëhen pjesë e këtij ekipi. Ndonëse me Ligjin për dialog, të miratuar në Kuvendin e Kosovës në dhjetor të vitit të kaluar, shoqërisë civile i është rezervuar një ulëse, megjithatë askush nga shoqëria civile nuk është bërë pjesë e këtij ekipi. Mirëpo, qysh në fillim, anëtarët e shoqërisë civile kanë dërguar vërejtjet e tyre për Ligjin për Dialogun, që konsiderohet antikushtetues.

Sipas Jeta Krasniqit nga Instituti Demokratik i Kosovës, në Ligjin për delegacionin shtetëror mungon

pjesa e përzgjedhjes së anëtarit të shoqërisë civile duke e vënë në pozitë më ndryshe me anëtarët e tjerë të këtij ekipi. "Nuk është e qartë, nuk ka transparencë apo nuk është qartazi edhe në ligj e përcaktuar si do të bëhet përzgjedhja. Në fakt, në ligj thuhet që do të nominohet nga dy krerët e delegacionit ose, nëse s'ka dakordim mes tyre, atëherë do të votohet edhe nga pjesa tjetër e delegacionit. Pavarësisht se si përzgjidhet një anëtar i shoqërisë civile në këtë delegacion, në mënyrën që është paraparë aty, nuk do të thotë që përfaqëson të gjithë shoqërinë civile të Kosovës", ka thënë Krasniqi për "Radion Evropa e Lirë".

Edhe Përparim Kryeziu nga Grupi

për Studime Juridike dhe Politike thotë se problemet për përzgjedhjen e anëtarit të shoqërisë civile fillojnë te projektligji. Sipas tij, mënyra se si rregullohet përzgjedhja e këtij anëtarit e bën atë automatikisht të pabarabartë me anëtarët e tjerë të delegacionit shtetëror dhe përfaqësuesi i shoqërisë civile nuk do ta kishte peshën e njëjtë në delegacion. "Përderisa anëtarët e delegacionit shtetëror janë votuar në Kuvend e kanë marrë legjitimitetin nga Kuvendi dhe mund të shkarkohen nga Kuvendi, anëtarit i shoqërisë civile mund të përzgjidhet nga delegacioni shtetëror. Pra, anëtarin e shoqërisë civile e përzgjedh delegacioni shtetëror dhe mund ta lirojë

nga puna po i njëjti delegacion. Pra, anëtarit i shoqërisë civile në këtë delegacion nuk është i barabartë me anëtarët e tjerë", ka deklaruar Kryeziu për "Radion Evropa e Lirë". Kryeziu thotë se nuk ka dhe nuk ka pasur deri tash një vullnet që të plotësohet kjo ulëse. "Delegacioni është formuar me qëllimin dhe arsyen se do të krijohet një trup gjithëpërfshirës që ofron pajtueshmëri politike sociale, prandaj është ftuar edhe një anëtar i shoqërisë civile, të paktën parashihet të jetë një anëtar i shoqërisë civile", është shprehur Kryeziu.

Ndërkaq Jeta Krasniqi nga KDI-ja ka thënë se shoqëria civile ka mënyrë se si i përzgjedh anëtarët. Fillimisht, përzgjedhja shkon

përmes nominimit dhe votimit nga shoqëria civile, e pastaj votimi në Kuvendin e Kosovës. "Ky anëtar i shoqërisë civile në delegacion të mos jetë vetëm sa për të përmbushur në mënyrë sipërfaqësore një kriter por, në fakt, konsultimi me shoqërinë civile të jetë i pranishëm në çdo fazë, për ta ofruar shoqëria civile opinionin e saj, qëndrimet e saj, kritikën konstruktive dhe për t'i garantuar transparencën dhe llogaridhënien", është shprehur Krasniqi.

Ekipi negociator, që bashkëudhëhiqet nga kryetari i Nismës Social Demokratike, Fatmir Limaj dhe kryetari i Partisë Social Demokratike, Shpend Ahmeti, qysh prej krijimit të ekipit negociator i kanë bërë thirrje shoqërisë civile që të bëhet pjesë e këtij ekipi. Përveç bashkëkryesuesve, pjesë e këtij ekipi janë edhe anëtarë të partive të tjera, duke përfshirë dy partitë më të mëdha opozitare, Lidhjen Demokratike të Kosovës dhe Lëvizjen Vetëvendosje, që kanë refuzuar të bëhen pjesë e këtij ekipi. Këto dy parti ekipin negociator të Kosovës e quajnë jolegitim.

Ndërkaq, ekipi negociator i Kosovës për dialogun me Serbinë aktualisht ka mbetur pa punë për shkak të mosvazhdimt të dialogut në Bruksel, i cili ka ngecur dhe është bllokuar.

Kurti bën homazhe në Malishevë për 20-vjetorin e çlirimit

MALISHEVË, 16 QERSHOR (ER) - Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, i shoqëruar nga kryetari i qendrës në Malishevë, Adem Berisha, veprimtari politik i çështjes kombëtare, Gani Krasniqi dhe bashkëpunëtorë të tjerë, të dielën ka bërë homazhe me rastin e përvjetorit të çlirimit të Malishevës dhe Ditës së Dëshmorëve në këtë komunë. Malisheva në luftën e fundit i ka dhënë kombit 72 dëshmorë dhe qindra martirë të vrarë e të masakruar. Malisheva, po ashtu, nga marsi '98-s deri në korrik '98 ishte shpallur edhe zonë e lirë. "Përgjatë asaj kohe në këtë zonë janë strehuar qindra e mijëra civilë, kanë qenë të vendosura institucionet drejtuese të luftës siç ishin Shtabi i Përgjithshëm dhe Radio Kosova e Lirë. Në këtë zonë kanë vepruar edhe dy brigadat,

Brigada 122 me Imer Krasniqin dhe Brigada 121 me Ismet Jasharin- 'Kumanovën'. Dëshmor i parë nga Malisheva ishte Imer Krasniqi i cili kishte rënë heroikisht më 16 qershor 1998 në Bllacë. Pas luftës në Kosovë qindra djem e vajza nga Malisheva i janë bashkuar organizimit të luftës së UÇPMB-se dhe Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare në Iliridë, ku ranë dëshmorë edhe tre djem nga Malisheva. Lavdi Dëshmorëve të Kombit dhe lirisë për të cilën ranë!", është thënë në njoftimin e Vetëvendosjes.

Në këtë përvjetor drejtuesit e Vetëvendosjes kanë bërë homazhe edhe te shtatorja e Adem Jasharit në Malishevë dhe te Varrezat e Dëshmorëve në Malishevë dhe në Kleqkë ku është i varrosur Ismet Jashari- "Kumanova".



I jepet lamtumira e fundit Lekë Zherkës

PRISHTINË, 16 QERSHOR - Të dielën është varrosur gazetari dhe drejtori shumëvjeçar i KTV-së, Lekë Zherka. Varrimi i tij është bërë në varrezat e qytetit të Prishtinës. Të dielën është mbajtur një

mbledhje përkujtimore për nder të jetës dhe veprimtarisë së tij. Lekë Zherka karrierën e ka filluar në Radio Televizionin e Prishtinës në vitin 1985. Pas luftës ai ishte drejtor i Radio Kosovës, pastaj

drejtor shumëvjeçar në televizionin Kohavision (KTV), ndërkaq karrierën e tij profesionale deri në ditët e sotme e vazhdoi në Radiotelevizionin 21 (RIV21). Lekë Zherka ka punuar menaxher

edhe në kompani të telekomunikacionit dhe në organizata ndërkombëtare humanitare që kanë vepruar në Kosovë. Lekë Zherka vdiq në moshën 56-vjeçare.



Zgjedhjet në LDK po përcillen me pakënaqësi

EPOKA
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 16 QERSHOR - Delegatët e Kuvendit Zgjedhor të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) në Mat, e cila është pjesë e degës së tretë të kësaj partie, e njohur si dega e presidentit Ibrahim Rugova, janë përleshur ashpër të dielën ndërmjet vete.

Në këtë përleshje delegatët kanë sulmuar njëri-tjetrin me karrige.

Pas këtij incidenti janë zgjedhur edhe drejtuesit e nëndegës së LDK-së në Mat.

Sherif Vrajolli është zgjedhur kryetar i nëndegës së LDK-së Mati në Prishtinë, ndërsa nënkryetar është zgjedhur Kreshnik Hoxha.

Dhuna në degët e kuvendeve zgjedhore të LDK-së në Prishtinë dhe në disa komuna të tjera është duke vazhduar tash e sa kohë. Skena të tilla u panë edhe në javën e kaluar në Kuvendin Zgjedhor të nëndegës së LDK-së në lagjen Mati 1, pjesë e degës së tretë në kryeqytet, ku është rizgjedhur kryetar Avdi Pireva. Ky i fundit ka akuzuar Arban Abrashin se po organizon veprime të tilla.

Pireva pati thënë në "Interaktiv" të KTV-së se Arban Abrashi kishte shkuar "me bandë" për ta prishur këtë Kuvend Zgjedhor të nëndegës së tretë të LDK-së në kryeqytet. Dy ditë më parë, kryetari i kësaj partie, Isa Mustafa, ka akuzuar mediet se po prodhojnë lajme të tilla. "Është e natyrës së mediave publike e private që të prodhojnë lajme, edhe me disa sjellje të papranueshme të disa individëve nga nëndegët e LDK-së. Por s'mund ta kuptoj ngarendjen e këtyre individëve që të prodhojnë lajme me budallallëqet e tyre dhe të njerëzve nga partitë e tjera që prishin tubimet e LDK-së", pati shkruar Mustafa në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai ka thënë se të gjithë duhet ta dinë se çdo proces zgjedhor i cili nuk respekton statutin e LDK-së, rregulloren e zgjedhjeve dhe që nuk është transparent ndaj anëtarësisë, nuk do të pranohet. "Si kryetar i LDK-së do të kërkoj nga organet përgjegjëse që ato të anulohen. Për rregullsinë e procesit zgjedhor vendimtare janë dispozitat e statutit të LDK-së dhe platforma zgjedhore, e jo konstatimet nga debatet e



atyre që s'kanë asgjë të përbashkët me LDK-në", ka deklaruar Mustafa.

Anëtari i Kryesisë së Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), njëherësh kryetar i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, pati deklaruar në një intervistë për gazetën "Epoka e re", se procesi ka pak telashe nëpër disa degë, por nuk janë aq të theksuara sa për të qenë shqetësuese për LDK-në. Ai e ka përjashtuar mundësinë që

këto zhvillime do të çojnë në ndarje të partisë. "Personalisht nuk mendoj se do të ndodhë një situatë e tillë. LDK-ja e ka provuar një situatë të tillë më herët dhe tashmë ka një pjekuri dhe maturi më të madhe. Nuk ka pasur konflikte, por tensione për shkak të numrit të madh të anëtarësisë nëpër nëndegë për të marrë pjesë në zgjedhje", është shprehur Imri Ahmeti.

Ahmeti ka theksuar se arsyeja e situatave të tensionuara nëpër

disa degë është tendenca për ta ruajtur postin me çdo kusht. "Unë jam i pakënaqur me procesin zgjedhor në disa degë në nivel vendi për arsye të tendencave të ruajtjes me çdo kusht të karriges së atyre që janë kryetarë dege dhe të pamundësisë së krijimit të një procesi fer në disa degë. Pra, arsyeja e situatave të tensionuara nëpër disa degë është tendenca për ta ruajtur postin me çdo kusht", ka thënë Ahmeti.

Pjesa e dytë e testit të maturës fillon më 19 qershor

Pjesa e dytë e testit të maturës fillon më 19 qershor në regjionin e Prishtinës, më 20 qershor në regjionin e Ferizajt dhe Gjilanit, më 21 qershor në regjionin e Prizrenit dhe Gjakovës dhe më 22 qershor në regjionin e Pejës dhe të Mitrovicës. Në pjesën e parë të testit të maturës në të gjitha regjionet janë përjashtuar 151 maturantë nga ky proces

EPOKA
ERE **Qendresa RAMA**

PEJË, 16 QERSHOR - Maturantët e regjionit të Pejës dhe të Mitrovicës kanë qenë të fundit që i janë nënshtruar provimit të maturës shtetërore 2019 për pjesën e parë, përderisa të premtën që lamë pas këtij provimi i janë nënshtruar maturantët në regjionin e Gjakovës dhe të Prizrenit.

Komisioni Shtetëror i Maturës (KShM) ka analizuar raportet e ardhura nga terreni pas ditës së fundit të provimit të maturës shtetërore dhe ka konstatuar se, në përgjithësi, testi ka shkuar mirë dhe nuk ka pasur parregullsi të mëdha të cilat do ta dëmtonin procesin as në Pejë e

Mitrovicë, por as në regjionet e tjera.

Në bazë të raporteve të pranuar nga dy regjionet e fundit, Pejës dhe Mitrovicës, të cilat kanë organizuar testin e maturës, për shkak të mospërfilljes së rregullave, janë përjashtuar nga procesi 26 nxënës, të cilët do ta humbin këtë afat të testimit. Ndërsa, tre administratorë do të përballen me masa disiplinore, si dhe ndaj dy drejtorëve të shkollave (në Pejë dhe Vushtrri), të cilët kanë penguar procesin, do të fillojnë procedurat e inspektimit.

Sipas raporteve të pranuar gjatë katër ditëve sa është mbajtur testi i maturës, në të gjitha regjionet janë 151 maturantë të cilët janë përjashtuar nga proce-



si dhe ata do ta humbin këtë afat të testimit.

Komisioni Shtetëror i Maturës ka falënderuar drejtoritë komunale të arsimit të komunave përkatëse, Policinë e Kosovës

dhe të gjithë aktorët e tjerë të përfshirë në proces për përgatitjet e duhura për këtë provim shtetëror.

Pjesa e dytë e testit të maturës fillon më 19 qershor në regjion-

in e Prishtinës, më 20 qershor në regjionin e Ferizajt dhe Gjilanit, më 21 qershor në regjionin e Prizrenit dhe Gjakovës dhe më 22 qershor në regjionin e Pejës dhe Mitrovicës.

Produktet amerikane përmes Kosovës në Evropë



PRISHTINË, 16 QERSHOR - Zona Ekonomike Amerikane në Kosovë, sipas pritjeve të institucioneve dhe përfaqësuesve të bizneseve, do të mund të tërheqë investitorë të shumtë amerikanë të cilët më pas produktet e tyre do t'i eksportojnë në tregun e gjerë të Bashkimit Evropian, i cili ka rreth 500 milionë konsumatorë.

Krijimi i Zonës Ekonomike Amerikane është bërë me një vendim të Qeverisë së Kosovës një vit më parë, por ende nuk është funksionalizuar. Lokacioni i kësaj zone është në Gjakovë dhe ka një sipërfaqe mbi 500 hektarë tokë.

Drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se Zona Ekonomike Amerikane ka tërhequr vëmendjen e disa kompanive amerikane që ta shtrijnë kapitalin e tyre në Kosovë. "Si Odë Ekonomike Amerikane në Kosovë tash e disa vjet promovojmë para investitorëve potencialë amerikanë idenë e shfrytëzimit të Kosovës si një zonë ku ata do të mund t'i prodhonin produktet e tyre, pastaj të njëjta t'i eksportonin në tregun Evropës, në tregun e 500 milionë konsumatorëve të Bashkimit Evropian. Kjo do të vinte edhe në një moment të përshtatshëm kur tregtia e lirë ndërmjet BE-së dhe ShBA-së nuk është në

nivelin e duhur", ka thënë Zeka. Ai ka shtuar se Zona Ekonomike Amerikane do të ishte mundësi e mirë për t'i tërhequr këta investitorë potencialë amerikanë. "Në bazë të informatave që kemi kjo (Zonë Ekonomike Amerikane) ka ngritur entuziazmin e kompanive, sidomos nga shteti amerikan i Iowas për të ardhur dhe për t'u vendosur në Zonën Ekonomike Amerikane kurdo që ajo të funksionalizohet dhe shpresoj që kjo të ndodhë sa më shpejt", ka theksuar Zeka.

Oda Ekonomike Amerikane e Kosovës tanimë ka dhënë rekomandimet rreth kësaj zone ekonomike dhe ato u janë dorëzuar autoriteteve kompetente. Zeka ka shtuar se Kosova si një treg i vogël nuk mund të jetë shumë atraktiv për investitorët prandaj, sipas tij, duhet krijuar lehtësira ekonomike. Edhe rekomandimet e dhëna nga Oda Ekonomike, sipas tij, duhet të jetësohen. Ai thotë të kanë pasur komunikim me Qeverinë e Kosovës sa iu përket disa detaje të Zonës Amerikane dhe se janë të vetëdijshëm që disa rekomandime kërkojnë ndryshime ligjore, por që ato mund të bëhen në një periudhë për aq sa edhe mund të funksionalizohet kjo zonë ekonomike. "Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë i ka dorëzuar Qeverisë së Kosovës një dokument që përmban

rekomandimet tona për funksionalizimin e asaj që njihet si qyteti ekonomik kosovar amerikan. Disa nga rekomandimet që ia kemi kërkuar qeverisë që do t'iu ofroreshin investitorëve brenda kësaj zone do të ishin pushimet tatimore në të ardhura të korporatës diku prej 10 vjetëve, përjashtim nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar për mallrat që do të furnizohen nga furnitorët vendorë e të cilat do të përpunoheshin brenda Zonës Amerikane. Po ashtu, kemi rekomanduar e procedura më të përsheptuara doganore, pra vendosjen e pikave doganore brenda zonës veçantë ekonomike amerikane, mekanizma për trajtimin e shpejtë të kontesteve të mundshme të bizneseve dhe Administratës Tatimore dhe të gjitha këto të ofrohen brenda zonës", ka thënë Zeka.

Lidhur me funksionalizimin e kësaj zone ekonomike Haki Shatri, këshilltar për ekonomi i kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, tha për Radion Evropa e Lirë se janë duke vazhduar përgatitjet për funksionalizimin e kësaj zone. "Qeveria e ka lejuar një sipërfaqe toke të konsiderueshme mbi 500 hektarë në afërsi të qytetit të Gjakovës për Zonën Amerikane, prandaj për këtë janë duke u krijuar kushte që të aktivizohet ajo sipërfaqe, janë marrë edhe vendime të tjera siç

është kyçja në autostradën e re që do të ndërtohet, kyçja në infrastrukturë ujore, pra të gjitha aspektet e infrastrukturës që i ndihmojnë zonës për t'u funksionalizuar janë marrë. Sa iu përket institucioneve të Kosovës, ne kemi larguar të gjitha pengesat dhe kemi marrë të gjitha vendimet që lidhen me këtë zonë. Por, presim të funksionalizohet në tërësi dhe bizneset nga Amerika të vijnë dhe ta nisin biznesin e tyre aty", ka thënë Shatri.

Themelimi i Zonës së Ekonomike Amerikane ishte konsideruar nga përfaqësuesit e Qeverisë së Kosovës si një dëshmi e partneritetit afatgjatë Kosovë - ShBA. Këtë zonë ekonomike e kishin konsideruar të një rëndësie të madhe për ofrimin e kushteve të nevojshme për investimin e kompanive të ndryshme nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Gjithashtu, ishte parë si mundësi e mirë për zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe rritjen e punësimit.

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, pati thënë se investitorët amerikanë në këtë zonë do t'i gëzojnë të gjitha privilegjet për ta bërë atraktive ekzistencën e kësaj zone për investime në Kosovë.

Ndërsa ish-komandanti i NATO-s, gjenerali Wesley Clark, i cili ishte i pranishëm në konferencën për sigurinë që u mbajt në

Prishtinë për 20-vjetorin e ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë, përveç të tjerash, theksoi se do të dëshironte ta shihte Kosovën si një vend evropian ku investitorët amerikanë do të ndiheshin të sigurt të investonin. "Ju keni nevojë për ligje të forta dhe të keni një sistem të fortë të drejtësisë. Ju keni nevojë për investime dhe unë do të doja të shihja që Kosova përmbush qëllimet e saj, që të bëhet vendi më miqësor për investime, vendi më mundësitë më të mira në Evropë për investimet nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ju jeni vendi më miqësor në Evropë dhe ne do të dëshironim të vinim këtu dhe presim nga ju që ta bëni një gjë të tillë", ka thënë Clark.

Zona e lirë ekonomike është një territor që ka një status të veçantë ekonomik. Ligji për zonat ekonomike në Kosovë parasheh katër lloje të zonave të lira ekonomike: zonat ekonomike apo parqet industriale, parqet teknologjike si dhe qendrat inovative. Investitorët amerikanë dhe investitorët e tjerë ndërkombëtarë në vazhdimësi ishte theksuar se përballen me shumë burokraci në komunat e Kosovës. Investimet e huaja direkte në Kosovë nga viti në vit kanë shënuar rënie. Derisa në vitin 2007 shuma e investimeve të huaja ishte në 440 milionë euro, në vitet e fundit vlera e investimeve të huaja mesatarisht arrin rreth 250 milionë euro.

Bizneset kërkojnë kthimin e bordit për shqyrtimin e ankesave

Përfaqësuesit e asociacioneve të bizneseve, Astrit Panxha dhe Skënder Krasniqi, e shohin të nevojshme rifunksionalizimin e bordit për shqyrtimin e ankesave që ka të bëjë me kontestet e bizneseve. Po ashtu, edhe prodhuesi vendor Burim Piraj ka theksuar rëndësinë e funksionalizimit të këtij bordi. Ndërkaq, këshilltari për çështje ekonomike i kryeministrit, Haki Shatri, e ka quajtur vendim të gabuar shuarjen e bordit për shqyrtimin e ankesave

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 16 QERSHOR - Përfaqësues të odave të bizneseve në Kosovë dhe prodhues vendorë kanë kërkuar kthimin e bordit për shqyrtimin e ankesave që merrej ekskluzivisht me lëndët e natyrës komerciale. Ata kanë theksuar se në sistemin gjyqësor ka zvarritje të lëndëve me vite dhe se kapacitetet e Gjykatës së Apelit janë të kufizuara për t'u dhënë verdikt lëndëve që presin me vite të tëra. Lidhur me këtë, Astrit Panxha nga Klubi i Prodhuesve të Kosovës ka thënë për gazetën "Epoka e re" se bordi për shqyrtimin e ankesave sa më shpejt duhet të rifunksionalizohet. "Ky bord duhet të kthehet dhe të jetë funksional sa më shpejt që është e mundur", ka thënë Panxha, duke shtuar se mosfunksionalizimi i këtij bordi është duke iu shkaktuar pengesa bizneseve në Kosovë për faktin se ato po përballen me vendime arbitrare dhe me procese të

tejzgjatura gjyqësore. "Lëndët janë duke u prolonguar me vite dhe kjo po shkakton mungesë të sigurisë ligjore për bizneset, ngadalësim të investimeve dhe rritjen e kompanive vendore", është shprehur Panxha. Edhe kryetari i Odës së Afarizmit të Kosovës, Skënder Krasniqi, ka kërkuar që të funksionalizohet ky bord. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se ekzistimi i Bordit për shqyrtimin e ankesave në të kaluarën i ka ndihmuar bizneset në zgjidhjen më të shpejtë të kontesteve të bizneseve. "Bizneset vazhdojnë të paguajnë për lëndët që u shkojnë në gjykata dhe presin me vite që të zgjidhen ato. Tani kemi një përpjekje të qeverisë që ta kthejnë këtë bord. Kjo është më shumë një përpjekje simbolike dhe për konsum ditor sesa ta ketë efektin e vet. Andaj, ky bord prapë do të ketë probleme dhe nuk do të mund të funksionojë në formën e njëjtë", ka thënë Krasniqi, duke shtuar se bordi i mëhershëm ka qenë i

pavarur dhe tani po mendohet që të shkojnë përmes Kuvendit dhe t'i dërgojnë njerëzit e tyre. "Mos të harrojmë se grumbullimi i lëndëve është duke e penguar ardhjen e investitorëve të huaj", ka thënë ai. Krasniqi ka shtuar se ankesat kryesore të bizneseve janë te mospagesat e rregullta dhe moszgjidhja e lëndëve gjyqësore ekonomike.

Prodhuesi vendor nga kompania "Meka", Burim Piraj, ka thënë se bordi për shqyrtimin e ankesave ka luajtur një rol të madh ndërmjetësues i cili u ka mundësuar bizneseve të kenë vendime më të shpejta. "Tani ka raste që marrin kohë deri në katër vjet derisa të arrihet te vendimi përfundimtar. Ky vendim nuk është i formës së prerë sa i përket kompensimit. Jo vetëm për firmën time, por për çdo kompani që ua mësyn investimeve në vendin tonë, me një sistem ankimor siç është ky, është shumë i dëmshëm. Mendoj se ka penguar shumë investime të cilat normalisht pasojnë dhe me humbje të hapjes së vendeve të reja të punës. Edhe institucionet duhet ta dinë se ky bord duhet të funksionalizohet sa më parë", ka thënë Piraj.

Zëdhënësi i Gjykatës së Apelit, Arbër Jashari, ka bërë me dije për gazetën "Epoka e re" se në Gjykatën e Apelit janë vetëm dy gjyqtarë që merren me çështje ekonomike. Sipas tij, aktualisht janë të pakryera 477 lëndë të cilat janë trashëguar nga vitet paraprake.

Shatri: Veprim i gabuar shuarja e bordit të ankesave

Këshilltari për çështje ekonomike i kryeministrit, Haki Shatri, vendimin për ta shuar bordin për shqyrtimin e ankesave e ka vlerësuar të gabuar. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se është më se i nevojshëm rifunksionalizimi i këtij bordi dhe se është bërë gabim kur është marrë vendim për suprimimin e këtij bordi. "Me ndryshimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe procedurat është suprimuar bordi i ankesave si institucion i pavarur profesional dhe është zëvendësuar me Divizionin Fiskal të Departamentit për Çështje Administrative pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë. Me këtë ndryshim procedurat e ankimit janë komplikuar dhe si rrjedhojë janë tejzgjatur. Koha e shqyrtimit të ankesave të palëve, siç deklarohen disa ankimes, është dy deri në tri vjet. Në anën tjetër, ankesa në divizionin fiskal palët që ankohen nuk i liron nga obligimi i deklaruar nga Administrata Tatimore apo nga doganat. Pala duhet ta shlyejë obligimin brenda afatit ligjor, njëkohësisht të ankohet. Kuptohet, nëse ankesa e palës është e arsyeshme. Vonesa e shqyrtimit të ankesës e dëmton palën", ka thënë Shatri, duke shtuar se bordi i shqyrtimit

të ankesave, i cili më parë ka pasur 15 anëtarë e më vonë është rritur në 17 anëtarë, ka qenë më efikas në aspekt të kohës. Në këtë drejtim ai ka theksuar se përgjigjet u janë kthyer palëve në afat, brenda dy ose tri javëve. "Pasuesi i dytë të riformulohet si vijon: Me draft-ligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat i cili është përgatitur nga MF-ja dhe është dërguar në Zyrën Ligjore, pra është në procedurë të miratimit, është paraparë rikthimi i Bordit të Ankesave, përafërsisht siç ka qenë deri në fund të vitit 2012", ka thënë ai. Zërave që ky bord nuk mund të jetë i pavarur, Shatri u është përgjigjur: "Me të pavarur se kur të emërohen nga Kuvendi nuk mund të jenë në asnjë formë. Kuvendi nuk bën biznes. Ky bord nuk ka për t'i kontrolluar as shqyrtuar lëndët e Kuvendit, por do t'i shqyrtojë ankesat e bizneseve që eventualisht pretendojnë se u është bërë e padrejtë eventualisht nga Administrata Tatimore e Kosovës apo Dogana e Kosovës", u shpreh ai. Shatri ka deklaruar se menjëherë pas shqyrtimit duhet të nisë procedura e përzgjedhjes së kandidatëve. "Bordi sigurisht se do të paguhet nga buxheti qeveritar dhe do të jetë lehtësim për bizneset", ka thënë Shatri.



Nderohet amerikani që ideoi dhe financoi kompleksin e UÇK-së në Marinë të Skenderajt

SKENDERAJ, 16 QERSHOR (ER) - Nën kryetari i Komunës së Skenderajt, Nuredin Lushtaku, dhe drejtorët komunalë, kanë pritur të dielën në takim Benito Maresin nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) i cili është ideatori dhe financues kryesor i projektit për ndërtimin e Kompleksit të Dëshmorëve në Marinë.

Gjatë bashkëbisedimit, nënkryetari Lushtaku e ka falënderuar mikun amerikan për realizimin e këtij projekti, i cili ka mundësuar që të gjithë dëshmorët e Drenicës të prehen të qetë në një vend.

Lushtaku ka thënë se Komuna e Skenderajt dhe të gjitha familjet e dëshmorëve janë falënderuese dhe të kënaqur me këtë projekt, ku homazhet për familjarët e tyre trima tashmë i bëjnë në Kompleksin e Dëshmorëve, në një hapësirë që po mirëmbahet shumë mirë, ashtu siç edhe e meriton heronjtë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Në shenjë falënderimi për kontributin e dhënë, në emër të kryetarit Bekim Jashari, nënkryetari Lushtaku i ka dhuruar Benito Maresit një dhuratë, ndërkaq në emër të tij personal i ka dhuruar stemën e UÇK-së me

figurat e ndritura të familjes Jashari: Shaban, Adem e Hamëz Jashari. Me këtë rast, Mares ka thënë se ndihet i nderuar me pritjen, shoqërimin miqësor dhe dhuratat e pranuar, të cilat, siç ka thënë ai, do t'i vendosë me kënaqësi në ambientin e tij shtëpiak. Benito Mares ka bërë me dije se do të fillojë edhe një projekt tjetër, i cili ka të bëjë me dokumentimin e luftës dhe kompleksit të UÇK-së në Marinë. Ai ka thënë se do t'i mbetet merak që nuk do të mund të marrë pjesë në ceremoninë e shënimit të 20-vjetorit të çlirimit të Skenderajt, por ka uruar të gjithë për këtë përvjetor jubilar.



Gjatë qëndrimit në Skenderaj, Moresi ka vizituar edhe Kompleksin e Dëshmorëve në Marinë dhe ka mbetur i kënaqur

me përfundimin e procesit të rivarrosjes së dëshmorëve të Drenicës si dhe me mirëmbajtjen e hapësirave brenda tij.



Evitohet rreziku në rrugën 'Enver Haradinaj' në Prizren

PRIZREN, 16 QERSHOR (ER) - Komuna e Prizrenit ka njoftuar se pas raportimit të qytetarëve për një gropë në rrugën "Enver Haradinaj" në Qendrën e Thirrjeve, menjëherë është lajmëruar Drejtoria e Shërbimeve Publike e cila ka intervenuar, duke sanuar këtë problem. Sipas Komunës së Prizrenit, kjo gropë në rrugë ka qenë përball urës së Marashit. "Me këtë rast janë ftuar kompanitë relevante që ta bëjnë evakuimin e rrugës si dhe

analizën e gjendjes së krijuar. Nga aty është vërejtur që problemi qëndron te gypat e vjetruar të sistemit të ujësjellësit dhe është kërkuar që në mënyrë emergjente të vijnë në ndihmë edhe ekipet e 'Hidroregjionit', si kompani publike përgjegjëse për rrjetin e ujësjellësit në Komunën e Prizrenit, e cila ka intervenuar menjëherë, duke rregulluar problemin dhe evituar rrezikun e paraqitur", ka njoftuar Komuna e Prizrenit.



Haziri ia dorëzon Edi Shukriut çmimin letrar 'Beqir Musliu'

GJILAN, 16 QERSHOR (ER) - Në Grykën e Karadakut, në shkollën "Bajram Curri në Shurdhan të Gjilanit, është mbajtur edicioni i nëntë i manifestimit rajonal të poezisë "Trekëndëshi poetik i paqes", pjesë e të cilit aktivitet ka qenë edhe ceremonia e dorëzimit të çmimit letrar "Beqir Musliu" për fituesen Edi Shukriu. Komuna e Gjilanit, në bashkëpunim me Ars Clubin "Beqir Musliu", kanë organizuar këtë ceremoni për t'ia dorëzuar shkrimtares dhe arkeologes Edi Shukriu këtë çmim letrar, të cilin e ndan kryetari i

Komunës së Gjilanit për arritje të veçanta në letërsi. Në fjalën e tij, kryetari i komunës Lutfi Haziri ka vlerësuar laureaten e çmimit "Beqir Musliu" Edi Shukriu si një fituese meritore e këtij çmimi. Ai ka vlerësuar kontributin e Beqir Musliut në periudhat më të rënda, por në të cilat është punuar me përkushtim, duke vënë në pah edhe aktivitetet e viteve të '90-ta. Madje, i pari i komunës e ka vlerësuar kulturën e asaj kohe si arma më e fuqishme që e kemi përdorur si rezistencë. "Karadaku dhe kjo

pjesë e Kosovës i nderon kotributdhënësit, mbi të gjitha, sepse kjo neve na bënë nder dhe ky çmim na ka nderuar me emrin tënd, shpallur nga juria si laureate dhe ne të falënderojmë për punën e madhe që ke bërë", i ka thënë Haziri, laureatës Edi Shukriut. Ndërsa Edi Shukriu ka thënë se ndihet e nderuar shumë, aq më tepër që shpërblimi mban emrin e shkrimtarit të saj të preferuar "Beqir Musliu". Ajo ka thënë se Gjilani ka bërë shumë për kulturën që, sipas saj, është qendër e kulturës.

Përurohen dy rrugë në Malishevë

MALISHEVË, 16 QERSHOR (ER) - Në Komunën e Malishevës janë përuar dy rrugë të reja të cilat në të njëjtën kohë janë shumë të rëndësishme, pasi lidhin shumë rrugë dhe vendbanime me rrugët magjistrale. Rrugët e përuara janë rruga "Avdullah Morina" që lidhë fshatin Burim me Astrazup dhe rruga "Drita" që lidhë fshatin Gurbardh me Dragobilin (lagja "Pallanka"). Në përuarimin e këtyre dy rrugëve ka marrë pjesë kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, nënkryetari Hajdin Berisha, drejtorët e drejtorive

komunale, Bashkim Krasniqi dhe Valon Mazreku, anëtarët e Kuvendit të Komunës së Malishevës, Ali Morina, i cili është edhe djali i dëshmorit Avdullah Morina, emrin e të cilit e mban njëra rrugë dhe Avdi Morina, si dhe qytetarë të tjerë të fshatrave Burim, Astrazup, Dragobil edhe Gurbardh. "Është ndjenjë e mirë kur e përfundon një projekt infrastrukturor, por është kënaqësi kur këto rrugë përurohen në data të caktuara, siç është Dita e Çlirimit dhe e Dëshmorëve, por edhe më mirë ndihemi kur rrugët, parqet dhe

objektet me rëndësi, mbajnë emra të dëshmorëve, që falë sakrificës së dëshmorëve të kombit dhe luftës së lavdishme të UÇK-së, ne sot po arrijmë t'i kemi këto të mira", ka thënë Begaj me rastin e përuarimit të këtyre rrugëve. Rruga Avdullah Morina është e gjatë rreth 1 800 metra dhe lidhë fshatrat Burim dhe Astrazup, ndërsa rruga "Drita" është e gjatë mbi 800 metra dhe lidhë lagjen Pallanka me fshatin Gurbardh. Të dy këto rrugë janë realizuar nga buxheti i Komunës së Malishevës.



Ta zgjidhim krizën pa kërkuar 'Vranitzky'-n



Koço KOKËDHIMA

Mazhoranca kërkon të bëjë zgjedhje e vetme, presidenti kërcënohet të rrëzohet dhe opozita nga Aleancën Qytetare, si komitetet e shpëtimit të vitit 1997.

Në maj të 1996-s zgjedhjet parlamentare u vodhën masivisht nga Berisha dhe u dënuan ashpër nga vëzhguesit ndërkombëtarë.

Partitë opozitare bojkotuan procesin. PD-ja fitoi 122 nga 140 vende në parlament.

Në vitin 1997 shembja e skemave piramidale solli humbjen e parave të qytetarëve dhe nxiti protesta të gjera antiqeveritare.

Presidenti Berisha shpalli shtetrrëhimin më 1 mars 1997 kur grupe të armatosura morën kontrollin e qyteteve. Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin Evropian dërgoi në Shqipëri një mision këshillues të drejtuar nga kancelari Franz Vranitzky, i cili ndihmoi në zbutjen e krizës politike, duke iniciuar dialogun mes qeverisë dhe opozitës.

E majta erdhi në pushtet me një mbështetje të madhe popullore dhe shkroi kushtetutën e vitit 1998, që nisi me fjalët: ne populli shqiptar...

Pajtimi që i bëri OSBE-ja politikanëve shqiptarë, i

shoqëruar me amnisti për krimet e tyre, u kthye në model, që në fakt përjashtoi vullnetin popullor, përfshirë edhe të drejtën për t'u zemëruar. Qysh nga viti 1997, marrëveshja e dy partive të vjetra ka rrënuar sundimin e ligjit dhe demokracinë pluraliste në Shqipëri.

Të huajt do të ishin pjesë, hartues dhe garantues të pakteve, ndryshimeve ligjore dhe certifikimit të pushtetit në këto 22 vjet të errët të demokracisë shqiptare.

Marrëveshjet do ta përcudnonin kushtetutën, aq sa sot nuk ka më ekuilibër dhe reputacion të institucioneve. Ministri i Jashtëm grek, Katrougalos, i cili ka punuar si këshilltar i reformave zgjedhore të viteve 2000, në Shqipëri, tani mund të vërë re përkeqësimin.

Pakti Nano-Berisha i vitit 2002 për zgjedhjet ishte baza e marrëveshjeve të mëvonshme Rama-Berisha dhe Rama-Basha. Pjesë e negociatave të vitit 2002 ishin edhe përfaqësuesi i OSBE-së Geert Ahrens dhe danezi Jorgen Grunnet i Këshillit të Evropës.

Më 17 mars 2002 është bërë një takim në OSBE, në zyrat e ambasadorit Ahrens. Aty u shkrua protokoll-marrëveshja PS-PD. Këtu u fut termi "reforma bipartizane konsensuale". Ishte thjesht ndarje pushtetesh në tryezë.

Mbi bazën e kësaj marrëveshjeje u vendos që të zgjidhej presidenti konsensual. Një ditë pas këtij takimi u shkarkua Prokurori i Përgjithshëm Arben Rakipi. Firmat e Nanos dhe Berishës do të hidheshin në zyrat e OSBE-së më 5 prill 2002.

Fotografitë e shtrëngimit të duarve të "dy armiqve" në atë

kohë, iu mjaftonin njerëzve për të justifikuar çdo pakt që ata do të bënin. Në këtë rrugë, Edi Rama në vitin 2008 firmosi ndryshimet kushtetuese famëkeqe dhe në vitin 2012 ato për Kodin Zgjedhor.

Marrëveshja e partive të vjetra është mbi ligjin dhe kushtetutën. Ato e kanë zhveshur popullin nga të gjitha të drejtat. Kryetarët e partive të vjetra kanë kapur shtetin, parlamentin, partitë, zgjedhjet, ekonominë, burimet, administratën etj. Gjithçka është në duart e këtyre tre-katër burrave.

Popullit i vijnë fatkeqësi edhe nga bashkëpunimi e marrëveshja edhe nga lufta mes tyre. Sepse asnjë luftë apo marrëveshje e tyre nuk bëhet për interesat e shqiptarëve! Asnjë!

Pse sot na udhëheq marrëzja dhe askush nuk kupton çfarë po ndodh? Pse është çmendur 'kali'? Pse sot në protesta kërkohet vetëm koka e Edi Ramës? Pse nuk kërkohen reformat jetike për vendin? Si ka mundësi që kur ua do puna këtyre dy-tre liderëve ne mbetemi pa parlament, pa deputetë, pa paqe e siguri, pa zgjedhje, pa Gjykatë Kushtetuese, pa Gjykatë të Lartë, pa kryetar të Kontrollit të Lartë të Shtetit, pa reformë zgjedhore? Mirë se punë, zhvillim e mirëqenie nuk po shpresojmë më! A nuk ju duket si e sajuar kjo situatë lufte? Çfarë është prishur që sot shantazhohemi me përplasje e konflikt civil dhe nuk po gjenet një pazar i ri si shumë të tjerë më parë?

"Është ekonomia, budalla", thotë një shprehje e famshme e Klintonit në 1992. Përveç makutërisë së paparë e të

padëgjuar ndonjëherë për të grumbulluar të gjitha pushtetet e Republikës në dorën e tij, Edi Rama ua kaloi në mënyrë të frikshme paraardhësve me pushtetin ekonomik që krijoi përmes hashashit, kriminit, korrupsionit dhe PPP-ve duke krijuar fonde e pasuri gjigante për vete dhe për klientët e tij. Por jo vetëm kaq. Duke përdorur mafien e marihuanës dhe kriminelët e çdo lloji, ai arriti të prishë të gjithë ekuilibrat.

Raportet duket se kanë ndryshuar në mënyrë të thellë. Kundërshtarët e tij ndihen të kërcënuar edhe penalisht, përveç se politikisht. PD e ka akuzuar Ramën se prishi konsensusin e 22 korrikut 2016 për të bërë reformën në drejtësi.

Me pak fjalë, PD dhe LSI duan prokurorin e përgjithshëm dhe të kenë veto në emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe të shtojnë në kohë krijimin SPAK, që e kontrollojnë SHBA dhe BE, sipas ndryshimeve kushtetuese.

Si reagim, opozita bllokoi për herë të parë, pas 15 vitesh pseudoreformën konsensuale zgjedhore.

Kjo përplasje i intereson kryeministrin. Edhe ai ndihet i kërcënuar për krimet që ka kryer në qeverisje. Vetëm në kushtet e kaosit, si ai i vitit 1997, mund të vihet në tryezë gjithçka bashkë me zgjedhjet, përfshirë Drejtësinë dhe amnistinë për veten e tyre.

Sot po përballet një autokrat që kërkon sundim dhe pasuri dhe një opozitë e pasinqertë, e paafte dhe e pabesueshme, që nuk ka vizion dhe as një platformë përbashkuese, por vetëm detashmentet e militantëve, që po i riorganizon në formën e komiteteve të shpëtimit.

Sot, me përpjekje teatrale në Bruksel, në Berlin e gjetkë, kryeministri po mundohet t'ua pikturojë situatën zyrtarëve të BE-së, në mënyrën sa më mirë për qeverinë. Ata e mbështetin të bëjë zgjedhjet i vetëm në 30 qershor. Duket sikur duan të shohin finalen e tragjikomedisë shqiptare. Një ndryshim tjetër në tablo vjen nga presidenti. Ai ka nxjerrë një dekret për shtyrjen e zgjedhjeve. Presidenti i dha kohë dhe mundësinë që të merren vesh Edi Ramës dhe opozitës rreth PD-së. Nëse kjo kohë harxhohet me komitete e aleanca shpëtimi, do të shkohet drejt kaosit dhe konsolidimit të tiranisë. Nëse zhvillohet një platformë kombëtare gjithëpërfshirëse e konsensuale me qëllim demokratizimin e qeverisjes, shtetit, partive dhe zgjedhjeve, paqja do të garantohet, sovraniteti i popullit do të rivendoset dhe do të ngushtohet në mënyrë domethënëse pushteti i kryetarëve të partive. Jo një pazar mes kryetarëve të partive. Jo një pazar si ai i 18 majit dhe as si shumë të tjerëve përpara tij. Ne të partisë 'Zgjidhja' këtë e quajmë Pakti Kombëtar për kapërcimin përfundimtar të krizës, Pakti Kombëtar për stabilitet demokratik dhe jo për stabilitet autokratik. Është momenti ta nisim këtë proces dhe t'ia mbërrijmë pa kërkuar një Franz Vranitzky të ri. Kjo është një provë e re që do vendosë shumë për të ardhmen e Shqipërisë. Të mos humbim kohë. Duhet të shembim sundimin e marrëveshjes së tre-katër njerëzve jo të lartë dhe të vendosim lirinë dhe rendin e ligjit në tokën tonë.

Sot do të ketë reduktime të energjisë elektrike në Mitrovicë

MITROVICË, 16 QERSHOR - Sot (e hënë) KEDS-i do ta bëjë kalimin në linja të reja të furnizimit në Mitrovicë. Për rrjedhojë, do të bëhet ndërprerja e nënstacionit Mitrovica 2 gjatë intervalit kohor 9:00-12:00. Sipas njoftimit të KEDS-it, nga kjo ndalesë do të jetë e prekur pjesa më e madhe e qytetit të Mitrovicës dhe pjesa më e madhe e fshatrave të kësaj komune. "Gjatë energjizimit mund të ketë ndalesa të shpeshta të energjisë elektrike, çka mund t'i afektojë pajisjet e ndjeshme, prandaj KEDS-i kërkon nga konsumatorët që t'i heqin pajisjet elektrike nga prizat. Ndërtimi dhe lëshimi në punë i linjave të reja që pasojnë ndërtimin e nënstacionit Ilirida të KOSTT-it është bërë që të ketë furnizim stabil dhe shumë më kualitativ me energji elektrike. Kjo pjesë që nga paslufta ishte furnizuar nga asetet transmetive të Trepçës, ndërsa pas djegies së tyre, si pasojë e mungesës së aseteve transmetive, furnizimi bëhej nga Shupkovci dhe linjës nga Skenderaj dhe Vushtrria", është thënë në njoftimin e KEDS-it.

torët që t'i heqin pajisjet elektrike nga prizat. Ndërtimi dhe lëshimi në punë i linjave të reja që pasojnë ndërtimin e nënstacionit Ilirida të KOSTT-it është bërë që të ketë furnizim stabil dhe shumë më kualitativ me energji elektrike. Kjo pjesë që nga paslufta ishte furnizuar nga asetet transmetive të Trepçës, ndërsa pas djegies së tyre, si pasojë e mungesës së aseteve transmetive, furnizimi bëhej nga Shupkovci dhe linjës nga Skenderaj dhe Vushtrria", është thënë në njoftimin e KEDS-it.



Pompeo: Shtetet e Bashkuara nuk duan luftë me Iranin

UASHINGTON, 16 QERSHOR - Shtetet e Bashkuara nuk duan luftë me Iranin, thotë sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo. "Megjithëse nuk ka asnjë dyshim që Irani ishte përgjegjës për sulmet ndaj dy anijeve cisternë këtë javë, Shtetet e Bashkuara nuk duan të hyjnë në luftë me Iranin", u shpreh të dielën shefi i diplomacisë amerikane.

Presidenti Trump ka bërë ç'është e mundur për të shmangur luftën, tha Pompeo duke shtuar se Amerika do të garantojë lundrimin e lirë përmes korridoreve të rëndësishme detare dhe për ta arritur këtë rezultat, do t'i marrë të gjitha masat e nevojshme, qofshin diplomatike apo të tjera". Irani mohoi të ketë pasur gisht në sulme dhe dje thirri ambasadorin

britanik në Teheran për të protestuar pasi autoritetet britanike fajësuan Teheranin për incidentin, siç njofton agjencia e lajmeve ISNA. Ndërkaq, anëtarët e ekuipazhit të cisternës norvegjeze që u sulmua këtë javë, mbërritën në Dubai pasi kaluan dy ditë në Iran. Të dyja cisternat janë tani në brigjet e Emirateve të Bashkuara Arabe.



Në Uashington nderohen viktimat e komunizmit

Ceremonia e nderimit të viktimave të komunizmit në botë këtë radhë përkon me 30-vjetorin e shembjes së Murit të Berlinit dhe 70-vjetorin e krijimit të NATO-s

UASHINGTON, 16 QERSHOR - Edhe këtë vit në kryeqytetin amerikan u nderuan viktimat e komunizmit në botë. Ceremonia këtë radhë përkon me 30-vjetorin e shembjes së Murit të Berlinit dhe 70-vjetorin e krijimit të NATO-s. Në ceremoninë e zhvilluar në Uashington morën pjesë edhe përfaqësues të komunitetit shqiptaro-amerikan. Nderim i veçantë iu bë figurës së Dom Shtjefën Kurtit i cili në kohën e regjimit komunist në Shqipëri u pushkatua vetëm se pagëzoi një fëmijë. Dom Shtjefën Kurti është një nga 38 martirët shqiptarë që shpalli Vatikanin dhe që u lumnuar në vitin 2016. Të mbijetuarit e komunizmit vlerësojnë lart figurën e tij dhe të gjithë të tjerëve që nuk iu nënshtruan diktaturës. Memoriali i viktimave të komunizmit në Uashington u rrethua të premtën nga kurora lulesh. Ato u sollën nga përfaqësues të 50 misioneve diplomatike në ShBA, përfaqësues vendesh, që ishin nën regjimin komunist dhe organizata për të drejtat e njeriut. Viktimat e komunizmit u nderuan edhe nga Ambasada e Shqipërisë në ShBA me një kurorë lulesh dhe një minutë heshtje pranë statujës së ashtuquajtur Zonja e Lirisë.

Po në këtë ditë u kujtua edhe figura e Dom Shtjefën Kurtit, meshtari shqiptar që ishte vik-

timë e regjimit komunist në Shqipëri.

Nipi i tij, Nikolin Kurti, ka porositur një kurorë lulesh në emër të gjyshit të tij, të cilën në memorial e vendosi drejtori i Qendrës Nënë Tereza në Nju Jork, Marian Cubi. "Në vitin 1944 komunizmi erdhi në pushtet dhe dy apo tri vjet më vonë u arrestua Shtjefën Kurti dhe u dënua me 20 vjet burgim. Atë e dërguan në kampin e Burrelit, ku vuajti jashtëzakonisht shumë, ashtu si shumë shqiptarë dhe shumë njerëz të tjerë nga komunizmi. Në vitin 1971 Atë Shtjefën Kurti bëri edhe pagëzime në kampin e përqendrimit dhe për këtë gjë u dënua me vdekje nga komunizmi. Ai u fut në listën e 38 martirëve që shpalli Vatikanin dhe në 2016-n përfundimisht u bë lumturimi i tij. Prandaj jam i sigurt se të gjithë duhet të mburren me rezistencën e Shtjefën Kurtit si një nga rezistuesit më të mëdhenj të komunizmit. Unë mendoj që ai do të mbetet i paharruar kurdoherë në historinë shqiptare", thotë Cubi.

Dom Shtjefën Kurti, ishte lindur e rritur në Kosovë, por regjimi jugosllav e detyroi atë të kërkojë paqe në Shqipëri, të cilën nuk e gjeti. "Është një nder i veçantë që iu bëjmë kujtimeve të komunizmit, për Dom Shtjefën Kurtin i cili është martiri i fundit i kishës



që u pushkatua nga komunizmi. Para se të pushkatohej, e pyetën: "A po të dhimbset jeta"? Ai u përgjigj: "nuk më dhimbset, por po më dhimbset sepse po ma merrni ju". Arsyeja që e pushkatuan ishte vetëm se pagëzoi një fëmijë. Figurat si ky kanë qenë të paimagjinueshme. Dom Shtjefën Kurti është figurë dhe martir i Kishës Katolike, po jo vetëm i kishës, por i tërë popullit shqiptar. Se ky është biri i Kosovës të cilin komunizmi e pushkatoi në Shqipëri", thotë Mark Memaqi, i mbijetuar i komunizmit në Shqipëri.

Rasti i tij kishte tronditur në atë kohë shqiptarët e Amerikës, të cilët nëpërmjet demonstratave dënonin ekzekutimin e Dom Shtjefën Kurtit. "Ne morëm vesh prej meshtarit tonë në atë kohë, Dom Zef Roshi, që na tregoi se ishte dënua me pushkatim

Shtjefën Kurti për shkak të një ceremonie. Në atë kohë, më 1971, si komunitet ne organizuam një demonstratë për këtë gjë që ndodhi në Shqipëri sepse ishte gjë e paimagjinueshme, që një meshtar të pushkatohej për detyrën e tij. Kjo ndodhi afro 50 vjet më parë", thotë Paulin Mernaqaj, i mbijetuar i komunizmit në Shqipëri.

Nderimi i viktimave dhe diskutimi për kohën e komunizmit, u shëron plagët të mbijetuarve të torturave që panë e përjetuan Shqipërinë e viteve 1944-1992. "Ne kemi ardhur këtu të prezantojmë Këshillin shqiptaro-amerikan, të vëmë një kurorë për viktimat të cilët humbën jetën dhe vuajtën sidomos te ne në Shqipëri, që mëmëdheu jonë krijoi kampe, vrau, torturoi popullin e vet. Diktatura sllavo-komuniste e Shqipërisë shkatërroi të gjithë

ata që nuk besonin në komunizëm, prandaj sot erdhëm të respektojmë viktimat që ranë kundër komunizmit", thotë Haxhi Dauti, i Këshillit Shqiptaro-Amerikan. "Kjo është një ditë që pak a shumë kur vijmë këtu ne rikujtojmë dhe na lehtësohen pak dhimbjet që përjetuam në atë masakër të tmerrshme. Flas për një Shqipëri që ka qenë diktatura më e tmerrshme në krahasim me vendet e tjera komuniste. Duhet t'ua transmetojmë edhe brezave tjerë, ta dinë brezat ardhshëm se çfarë është komunizmi që të mos ndodhë më në të ardhmen", thotë Tasim Ruko, i degës së organizatës "Vatra" në Tampa, Florida. Fondacioni i Memorialit të Viktimave të Komunizmit organizon çdo vit një ceremoni të tillë ku nderon figura të njohura të kohës.

Erdogani thotë se sistemi raketor rus S-400 do të arrijë në Turqi në korrik

ANKARA, 16 QERSHOR - Turqia do të pranojë sistemin raketor të mbrojtjes S-400 nga Rusia në fillim të korrikut, ka bërë me dije presidenti Rexhep Tajip Erdogan të dielën. "Besoj se sistemi raketor S-400 do të fillojë të arrijë në pjesën e parë të korrikut", ka thënë Erdogan, raporton shërbimi turk i agjencisë CNN. Marrëveshja e Ankarasë me

Moskën ka futur në tensione Turqinë dhe Shtetet e Bashkuara për shkak se kjo e fundit thotë se sistemi i mbrojtjes S-400 është kërcënim ndaj avionëve të saj F-35. ShBA, po ashtu, ka paralajmëruar Turqinë për sanksione të mundshme nëse nuk tërhiqet nga marrëveshja me Rusinë. Ushtruesi i detyrës së

Sekretarit të Brendshëm në ShBA, Patrick Shanahan, këtë muaj theksoi se Turqia do të përjashtohet nga programi i avionëve F-35 nëse fillon blerjen e sistemit raketor nga Rusia. Erdogan kishte thënë se do të diskutojë për këtë çështje me presidentin Donald Trump në Samitin G-20 që pritet të mbahet këtë muaj.



FALENDERIM PUBLIK!



Ismet SYLEJMANI

Në prag të 20 vjetorit të çlirimit të Atdheut tonë Kosovës nga Serbia pushtuese, që u realizua me luftën titanike e heroike të USHTRISË ÇLIRIMTARE TË

KOSOVËS dhe ndihmës kolosale e vendimtare të SHBA-së dhe NATO-s, e në 20 vjetorin e çlirimit të Komunës së Gjilanit, njëra nga rrugicat e lagjes së Smakajve në fshatin tonë Cernicë, nderohet me emrin e stërgjyshit tonë

Sylejman Sylejmani, luftëtarit të lavdishëm të çetave liri-dashëse të Komandantit e strategut legjendarë të Grykës së Kaçanikut Idriz Seferi! Në emer të fisit të Babës Syle dhe në emrin e familjes së madhe 93 anëtarëshe

Sylejmani që jetojmë në këtë rrugicë në lagjen e Smakajve, e falenderojmë komisionin e të gjitha niveleve të Komunës së Gjilanit për përcaktimin dhe vendimin që kjo rrugicë tani e tutje të mbaje emrin e stërgjyshit tonë!

Pjestarët e familjes SYLEJMANI të Lagjes SMAKAJ!

*Ismet Sylejmani Ish- Anëtar e Zëdhës i Komandës së Shtabit të Zonës Operative të Karadakut të UÇK-së!
Cernicë, më 16 Qershor 2019!*

OPINION E PREMITE, 6 DHJETOR 2017 **EPOKA E RE** 13

BABA SYLË



Ismet SYLEJMANI

Historia e popullit shqiptar është historia luftërash e lirishtash të mëdha e të lavdishme për liri e pavarësi, mirëqenie e përparim të djepit e kulturës evropiane, ka i takonte dhe dëshironte të ishte, e jo atje ku dëshirojnë të deklinon pushtuesit osmanë. Lufta heronjë e popullit shqiptar kundër Durrëzimit Osmanë është një nga faqet më të lavdishme të epokës titanike me armë në duar!

Gryka e Kaçanikut është heronjë më e madhe dhe e fundit kundër pushtuesit osmanë. Më jehonën e saj kjo betejë legjendarë ka lënë gjurmë të mëdha dhe të pashlyeshme dhe ka bërë ndalinë të madhë pushtuesit luftëtar dhe betejat e mëvonshme që i ka shpallur popullit shqiptar kundër pushtuesit nazifashist gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe kundër Serbisë pushtuese gjatë luftës së UÇK-së. Një nga personazhet që me luftën e vetë të armatosur çlirimtare përkatë bashkëluftetarëve dhe të komandantit e strategut të grykës së lavdishme e të pamposhtur të Kaçanikut, Heronit të Komandit Idriz Seferi, ka qenë edhe stërgjyshi Yni, i madhi dhe i pavarëskohur Baba Syle.

Stërgjyshi, babëku ynë Syle Sylejmani, është lindur në Cernicë në vitin 1924 dhe ka vdekur në vitin 1924.

Në moshën 39 vjeçare, me armë në dorë, me një pistoletë kalibër e armatosur çlirimtare.

Atdheut, mbylltë shtëpi-përgjithësisht.

Eshtrë varrosur në varrezat e Babës Cernicë, në lagjen Smakaj. Vendi i Babës Syle është zbuluar nga pushuesit tonë dhe vegjet e tyre shpëtojëse.

Nuk dhetet se nën varrin e cilit pëngjatur të famëlirëve të tij të vdekur e të varrosur më vonë, i janë ndaluar eskizat me edhe i janë zhvarrosur kreqi, për t'u shuar sarrë përgjithësisht.

Përpos fotore me bashkëluftetarë, që thuhet se është në ato foto, të tjerat foto ku është veprimi Ai veprimi me me familje më ka, sepse me natën e aranzimit dhe hapjes, i është konfiskuar gjithçka.

Gjiljanit, çdo gjë e shtrëngim personale e tij ka marrë fund dhe mbetur zbuluar edhe me rastin e djepit të shpëtojë të tij.

Tanë, pas vendosjes së shatërvan në llozin të Komandit Idriz Seferi në Gjilan, ndërmori për Babën Syle merr kapiten edhe më të madhë.

Ndodhet në të ardhmen dhe të shohim të shallur në një pllakë afit shatërvan të strategut të grykës së Kaçanikut, emrat e bashkëluftetarëve të çetës së Tij heroike antipushtuese turke.

Stërgjyshi Yni Baba Syle ishte dhe mbetet luftëtar e heroik në zemër të lavdishmë të luftës së armatosur çlirimtare kundër pushtuesit dhe tradhtarëve të popullit e të Atdheut tonë.

Ai me jetën e tij të vitit në shërbim të popullit dhe me luftën e armatosur në shërbim të Atdheut nga pushtuesit, ishte frymëzimi ynë i madh kundër pushtuesit më popullin tonë edhe në luftën titanike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kundër Serbisë pushtuese.

Ne, pasardhësit e Babës Syle, me krenari e mburje-lobim të rëndësuar përkatë luftëtarëve e komandantëve të luftës legjendarë të UÇK-së për çlirim të tokave shqiptare të Kosovës dhe vlerave të saj nga pushtuesit.

Babëku, pasardhësit e gjakut tënd, admi sikur ti dikur, janë shkuar ballë për ballë e përme grykës së pushtës me armë të Vendet, kane dëshe korretit të drejtpërdrejtë për çlirim me armë në duar nga pushtuesit serbë të vendit tonë.


Babëku, Atdheut ynë për të cilin ti ke luftuar dhe je burgosur e torturuar pamëshirshëm në burgjet osmanë, pas një shokëri robëri që aihtarë kur pushoi së rënduri osmanë lote e madhe, për pushim 100 vjetë restoi nga zgjedhja e pushtuesit serbo-jugosllavë, por pas luftës titanike të UÇK-së dhe ndihmës së madhe që na e ka dhënë Nënë Shqipërisë dhe shpatë e mëdhësi të SHBA-ja, Gjermania, Anglia dhe NATO-ës, tani Kosova është e lire dhe e pavarur.

Nuk do të jemi të qetë kurë as në herë ynë, por as gjeneratë që do të vijin, derisa nuk e gjëjmë shtatin e koskave tua dhe të përulimi me respekt e nderim, sepse ti ja veprimi të stërgjyshit ynë e i lindidom e kryeqytet, por je edhe luftëtar me armë në duar i Atdheut nga pushtuesit tonë dhe serbit!

Lavdi e përjetshme Babës Syle! Lavdi Heronit të Komandit Idriz Seferi!

Lavdi gjakut të dendur për liri!


Prishtinë, 7 shtator 2017




Strategu e luftëtarit i lavdishëm i luftërave antiosmane me bashkëluftetarë pas betejave heroike dhe Grykës së pamposhtur të Kaçanikut

IDRIZ SEFERI

Në mesin e këtyre luftëtarëve heroik edhe i pavdekshmi stërgjyshi ynë nga Cernica e Gjilanit **Baba Syle Sylejmani**





E jashtëzakonshme

I propozon fejesë të dashurës me unazën në hamburger

Një vajzë që pritet të jetë nuse e ardhshme ka marrë shumë mesazhe talljeje në rrjet pasi publikoi propozimin që i dashuri i saj i kishte bërë: unaza e fejesës në mes të një hamburger të madh të McDonald's Propozimet për



martesë janë aq të rëndësishme sa edhe vetë dita e dasmës, kur tërheqin të gjitha vështrimet, sidomos me uljet në gjunjë.

FOTO E DITES



Faza e parë e garës me biçikleta në Francë. Fotografia nga: Anne-Christine Poujoulat /AFP/

E rrallë

Gruaja ngec brenda makinës lodër

Një grua ka ngecur brenda një makine lodër për gati një orë. Gruaja skoceze u fut në makinën lodër si pjesë e një shakaje me familjarët e saj. Por 34-vjeçarja, Zoe Archibald ngeci brenda saj. Ishte babai i saj që i erdhi në ndihmë. Ai preu makinën plastike me anë të



një thike kuzhine dhe pas një ore Zoe ishte e lirë.

BARSOLETA E DITËS



Një person po e shkeli vetura në Veternik dhe po del shpejt shoferi prej veturës: O më fal zotëri se nuk të pash hiq. I aksidentuari: S'ke ti faj o vëlla, se unë ma shumë rri në Ferizaj.




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit ne ora 14:00

“DUMBO” 3D

Fantazi/Familjar; 1 ore 52 min

Rolet: Colin Farrell, Michael Keaton, Danny DeVito, Eva Green, Alan Arkin, etj.
Regjia: Tim Burton



Ne ora 16:00 dhe 19:00
“AVENGERS; Endgame”

Aksion/Aventurë/Fantazi; 3 ore 02 min

Rolet: Robert Downey Jr., Chris Evans, Mark Ruffalo, Chris Hemsworth, Scarlett Johansson, Don Cheadle, Bradley Cooper, Gwyneth Paltrow, Jeremy Renner, Josh Brolin, etj.
Regjia: Anthony Russo, Joe Russo



Në ora 20:00

“EXTREMELY WICKED, SHOCKINGLY EVIL, AND VILE”

Krim/Mister; 1 ore 48 min

Rolet: Zac Efron, Lily Collins, Kaya Scodelario, Jeffrey Donovan, Angela Sarafyan, Dylan Baker, John Malkovich, etj.
Regjia: Joe Berlinger



16.05.2019

“THE HUSTLE”

Komedi

Rolet: Anne Hathaway, Rebel Wilson, Alex Sharp, Dean Norris, etj.

Regjia: Chris Addison



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

 <p>DASHI Dita sot do të fillojë me një surprizë të këndshme. Edhe pse nuk është ajo që prisnit përsëri do të kënaqeni me aq sa do t'ju jepet.</p>	 <p>DEMI Sot do të keni lëvizje shumë të forta emocionale. Kjo ditë që nisi shumë qetë mund të kthehet në një nga ditët më të paharruara për ju.</p>	 <p>BINJAKËT Këto kohë nuk keni mundur të frenoni situata të sikletshme të provokuara nga persona që nuk kanë marrëdhënie shumë të mirë me ju.</p>	 <p>GAFORRJA Keni marrë shumë informacion nga fusha të ndryshme dhe ndiheni mjaft i mbushur shpirtërisht. Këto ditë duhet t'i kaloni me pranë familjes.</p>	 <p>LUANI Sot përfitimet tuaja nga një projekt do të jenë mjaft të dukshme. Kjo gjë do të manifestohet me batuta xhelozie nga kolegët.</p>	 <p>VI RGJËR ESHA Mbase keni frikë të merrni përgjegjësi të reja mbi vete, por nëse ju pëlqejnë sfidat, duhet ta provoni. Çdo gjë e ka një të mirë nga pas.</p>
 <p>PESHORJA Nëse e ndjeni veten jo shumë të mirëkuptuar nga partneri sot, mbase duhet të uleni dhe të diskutoni për ngërçin që ka lidhja juaj.</p>	 <p>AKREPI Ka shumë persona që nuk kanë besim tek ju sepse nuk keni vënë asnjëherë në praktikë ato që keni thënë.</p>	 <p>SHIGJETARI Nëse e shihni çdo gjë më optimizëm dhe e ardhmja do t'ju duket shumë e mirë dhe me mjaft mundësi të reja për të shfrytëzuar.</p>	 <p>BRICJAPI Mund të jeni krenarë për veten dhe sidomos për pjesëtarët e familjes tuaj. Sot do të tregoni që jeni më shumë se kurrë bashkë në qëllime të mira.</p>	 <p>UJORI Sot do të merrni vendime edhe për persona të tjerë pranë jush që nuk kanë mundësi të vendosin për gjëra të mëdha në jetën e tyre.</p>	 <p>PESHQIT Bëni një bashkëbisedim me veten sot për të kuptuar se kush janë gjërat që kanë vërtet rëndësi në këto momente në jetën tuaj.</p>

Elle dhe Max të lumtur me njëri-tjetrin

Elle Fanning dhe Max Minghella janë më të fortë se kurrë. Aktorja 21-vjeçare është parë dorë për dorë me aktorin 33-vjeçar në fundjavë gjatë një shëtitje në Silver Lake, California. Elle dukej bukur në një fustan të verdhë, ndërkaq Max një bluzë ngjyrë hiri dhe xhinse, teksa kanë bërë pazar bashkë. Çifti u takua gjatë punës në filmin "Teen Spirit".



Kim Kardashian flet hapur për problemin që ka me lëkurën



Influencesja më e madhe e modës dhe make up-it në botë, Kim Kardashian West, ka ndarë me ndjekësit e saj në "Instagram" një problem që ajo ka me lëkurën, problem të cilin askush nuk e kishte ditur më parë. Në një video të publikuar, ajo ka treguar se si është lëkura e këmbëve të saj, e

depigmentuar dhe me venat që dukeshin qartë. Ajo ka treguar sekretin e saj për ta mbuluar këtë defekt që ka pasur me kohë, si dhe ka vendosur që me këtë produkt t'u vijë në ndihmë shumë personave që vuajnë nga i njëjti problem, duke paralajmëruar lansimin e tij më 26 qershor.



Dua Lipa shumë shpejt publikon albumin e dytë

Këngëtarja e njohur botërore me prejardhje nga Kosova, Dua Lipa, do ta publikojë shumë shpejt albumin e saj të dytë në karrierën muzikore. Këtë

e ka bërë me dije babai i saj, Dukagjin Lipa, në një intervistë për "Art Motion". Lipa ka theksuar se Dua e bën krenar me muzikën dhe karrierën e saj.


Madona: "Instagram"-i i bënë njerëzit të ndihen keq



Madona ka kritikuar rrjetin social "Instagram", duke thënë se skllavëron njerëzit në përpjekje për ta marrë miratimin e të tjerëve. Ndërhyrja e këngëtares së popit, që ka rreth 14 milionë ndjekës në platformën e ndarjes së fotografive, vjen në mesin e një fokusi

në rritje të pasojat e dëmshme që "Instagrami" mund të ketë, veçanërisht të rinjtë. "Ti gjendesh duke krahasuar veten me të tjerët. A duhet të jetë kështu, të veprosh kështu, të dukesh kështu? Unë mendoj se 'Instagram'-i i bënë njerëzit të ndihen keq", ka thënë ajo për "the Sun".

I nxehti afrikan/ Ja gabimi që bëjnë të gjithë me përdorimin e paracetamolit



Ditët e fundit, Kosovë është përballur me temperature mjaft të larta, duke shkaktuar edhe probleme, sidomos moshat e treta. Nisur pikërisht nga vapa e madhe, autoritetet shëndetësore japin disa rekomandime.

Një prej tyre është mbajtja freskët e shtëpisë, ose ambientit. Temperatura e ambientit ku jetoni duhet të mbahet nën 32°C gjatë ditës dhe 24°C gjatë natës. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për të porsalindurit, për individët mbi 60 vjeç, apo për ata që kanë probleme shëndetësore kronike.

Freskoni shtëpinë gjatë natës. Hapni të gjitha dritaret dhe gratat gjatë natës dhe në mëngjes, atëherë kur temperatura e jashtme ulet.

Mundohuni të ulni temper-

aturën në shtëpi. Mbyllni gratat dhe dritaret, veçanërisht ato që preken nga dielli. Mos mbani llambat ndezur, reduktoni vënien në punë të pajisjeve elektrike të gatimit apo larjes, etj.

Nëse keni kondicioner, mbyllni dyert dhe dritaret me qëllim ruajtjen e temperaturës së brendshme, duke zvogëluar kështu konsumin e tepërt të energjisë.

Shmangni të nxehtët

Qëndroni në dhomën më të freskët të shtëpisë, veçanërisht gjatë natës. Në pamundësi për të mbajtur shtëpinë të freskët, shpenzoni 2-3 orë të ditës në mjedise të freskëta jashtë shtëpisë (p.sh. ambiente publike). Shmangni daljen nga

shtëpia gjatë orëve më të nxehta të ditës.

Shmangni aktivitetet fizike me intensitet të lartë nëse mundeni. Nëse duhet të bëni patjetër aktivitet fizik, atëherë shfrytëzoni orët e mëngjesit. Qëndroni në hije. Mos lini fëmijët apo kafshët në një automjet të parkuar. Konsultohuni me mjekun nëse nuk ndiheni mirë apo nëse gjendja juaj nuk përmirësohet. Mundohuni të mbani trupin të freskët dhe të hidratuar.

Bëni dush me ujë të ftohtë.

Vishni rroba të lirshme, mundësisht me materiale pambuku ose linoje. Nëse dilni nga shtëpia mbani kapelë me strehë të gjerë dhe mos harroni syzet e diellit.

Mundohuni të flini pa jastëk dhe të pambuluar për të mos akumuluar nxehtësi. Pini rregullisht lëngje por shmangni alkoolin, kafet e tepërta dhe sheqerin. Konsumoni ushqim në racione të vogla dhe shpeshherë. Shmangni ushqimet e pasura me proteina.

Ndihmoni të tjerët

Kontaktoni me familjarët, miqtë dhe fqinjët të cilët jetojnë vetëm, pasi në ditët e nxehta mund të kenë nevojë për asistencë. Diskutoni për situatat e të nxehtëit ekstrem me familjen. Gjithsecili duhet të dijë se si të zvogëlojë rreziqet shëndetësore në këto situata.

Nëse ndokush që ju njihni është në rrezik, ndihmoheni atë të kërkojë ndihmë. Të moshuarit

dhe të sëmurët të cilët jetojnë vetëm duhet të kontaktohen të paktën një herë në ditë.

Nëse një person është duke marrë mjekim, pyesni mjekun që e trajton nëse mjekimi që po merr ndikon në funksionimin normal të organizmit, e lidhur kjo me vapën; këtu kemi parasysh mekanizmat termoregullatore dhe balancën e lëngjeve në organizëm.

Nëse ju keni një problem shëndetësor

Mbani ilaçet në temperaturën nën 25°C ose në frigorifer. Kërkoni ndihmë mjekësore nëse vuani nga ndonjë sëmundje kronike apo nëse merrni më shumë se një ilaç. Nëse ju apo dikush tjetër nuk ndihet mirë, kërkoni ndihmë nëse ndiheni i turbulluar apo i këputur, nëse keni dhimbje koke, gjendje ankthi apo etje shumë të madhe dhe të vazhdueshme. Zhvendosuni menjëherë në një mjedis të freskët dhe matni temperaturën e trupit.

Pini ujë apo lëng frutash për t'u hidratuar.

Nëse njëri nga pjesëtarët e familjes ka lëkurë të nxehtë dhe të thatë, dridhje të forta apo gjendje të fikti, lajmëroni menjëherë mjekun e ambulancës. Ndërsa prisni për ndihmë, zhvendoseni të sëmurin në një dhomë më të freskët, vendoseni në pozicion horizontal mbështetur në njërin anë, ngrijani këmbët pak nga pozicioni horizontal, mundohuni ta freskoni duke e lagur me ujë dhe mos i jepni paracetamol.

Dush i ftohtë apo i ngrohtë? Ja cili është më i shëndetshëm

Sigurisht se ju ka rastisur edhe juve që të dëgjoni se dushi me ujë të ftohtë është i shëndetshëm, mirëpo a është e vërtetë? Për këtë enigmë ka shkruar edhe ish-marinsi amerikan Clint Emerson, autor i disa librave për ushtrime ushtarake, shpjegon se përse është e shëndetshme që dushin ta përfundojmë me ujë të ftohtë.

“Uji i ftohtë do t’ju zgjojë, pa dyshim, dhe do t’ju mbajë zgjuar, por ka më shumë përfitime shëndetësore se çdo gjë tjetër. Në stërvitjen e forcave detare amerikane kaloni shumë kohë në ujë të ftohtë dhe ka një fakt shkencor për çmendurinë na fut në ujë të ftohtë. Një arsyeja pse atletët profesionistë e

bëjnë këtë gjatë gjithë kohës pas një stërvitjeje, është se rritet shërimi. Ai vaksinon gjithë trupin, duke e zhveshur nga acidi laktik, në mënyrë që të ndjeheni mirë për të shkruar ditën tjetër dhe të jetë gati për trajnimin e ditëve të ardhshme”, thotë Clint Emerson.

Sipas tij uji i ftohtë është terapi, edhe pse duket torturë.

“Është një terapi në mënyrë që të mbaheni të shëndetshëm, mban ënjtjet të ulëta dhe ju lejon të vazhdoni të ecni përpara, me shpresë pa asnjë dëmim të mëtejshëm”, shpjegon ai.



Mëndafshi 2600 vjeçar i zbuluar në Shqipëri


Tekstili më i vjetër prej mëndafshi, i zbuluar në Shqipëri është më se 2600 vjeçar. Kështu deklaroi studiuesi dhe restauruesi Frederik Stamati, i cili vjen me një tjetër dëshmi të trashëgimisë sonë kulturore.

Sipas tij, ky tekstil mëndafshi është zbuluar në Apoloni, brenda një urne prej bronzi. "Urnën nuk po e paraqesim, gjithsesi ajo është e ekspozuar në Muzeun arkeologjik të Apolonisë. Natyrisht që nuk ka qenë një thërrime, si edhe ka mbetur, por një veshje që hidhej krahëve. Është shumë e hollë, në çdo 10 cm ka më shumë se 1000 fije mëndafshi. Ka pamjen e ngjashme me atë të thurjes së kanistrës", tregon Stamati.

Sipas tij, brenda në urne ishte

kthyer në një pluhur të zi, ku kishte shpëtuar vetëm kjo pjesë e ekspozuar në fotografi. "Një pjesë e pëlhurës së mëndafshit kishte dale nga urna dhe i ishte veshur asaj nga jashtë. Ruhet si imazh mineralesh korrozioni, të cilin nuk e kemi hequr. Nëse do t'i shikoni me kujdes fotot, do të dalloni se në këtë "bllok" janë dy tekstile. Ai në foton e dytë është endur më rrallë. Bën pjesë në tekstilet e endura me dy lisa, ose si i quan sot industria tekstile, garniturë", - nënvizon Stamati.

Stamati shprehet se në urnë kanë qenë futur veç të tjerave dy tekstile, të përdorura si veshje të asaj kohe. Nga duart e Mjeshtrit dhe Profesorit Frederik Stamati kanë dalë në dritë mjaft materiale dhe dëshmi historike të kombit tonë.



Shqipëria me thesar nënujor, zbulime që nga Afrika e Veriut dhe Perandoria Romake



Me një thesar të vërtetë përgjatë bregdetit të thyer dhe thellësive të Jonit dhe Adriatikut, Shqipëria mund të kthehet në një destinacion turistik shumë të rëndësishëm për të apasionuarit e turizmit nënujor. Amfora të lashta, anije terrakote të mbytura tekta lundronin në linjat e Afrikës së Veriut dhe Perandorisë Romake e të tjera të mbytura gjatë luftërave botërore së bashku me sende personale të ekuipazheve gjallojnë nën shoqërinë e kolonive të peshqve dhe sfungerëve detarë. Kjo anije e ankoruar në portin e Durrësit është ndërtuar

për kërkime arkeologjike nënujore. Ajo është e pajisur me një robot që zhytet në thellësi të mëdha dhe i përket Fondacionit Amerikan RPM Nautical Archaeology që së bashku me Qendrën Shqiptare të Kërkimeve Detare kanë realizuar një ekspeditë 12-vjeçare në brigjet shqiptare. Gjatë saj janë zbuluar objekte që shtrihen nga epoka e bronxit e deri në vitet e luftës së ftohtë, 1946-1947. Sipas kryetarit të Këshillit Shkencor e Teknik të Pasurive Botërore Nënujore të UNESCO-s Auron Tare, këto gjetjemund të ndryshojnë dhe historinë

antike të brigjeve shqiptare, veçanërisht atë të periudhës romake.

"Është një ekspeditë e rrallë dhe zbulimet e saj mund të ndryshojnë historinë antike" - thotë Auron Tare dhe shton se pavarësisht kësaj pasurie dhe rëndësisë që ajo mbart, strukturat në Shqipëri janë ende të paplota. Vendi nuk ka ende një departament të Arkeologjisë Nënujore, ndërsa veprimtaria e trafikantëve të objekteve nënujore antike, peshkatarëve, gjuetarëve të skrapit po dhe subjekteve të tjera e rrezikon atë. Por e gjithë kjo pjesë pozitive

duhet të kthehet në realitet për ruajtjen e mbrojtjen e pasurisë nënujore si në aspektin ligjor dhe atë praktik ku ka shumë për të përmirësuar si nga ana legislative ashtu dhe nga ajo praktike. Për arsye nga më të ndryshmet kjo pasuri rrezikohet, duke nisur që nga peshkatarët që mund të dëmtojnë anijet antike, po dhe nga ata që presin për skrap anijet e Luftës së Parë e të Dytë Botërore, po dhe institucionet shtetërore që nuk e kanë idenë e vlerës së tyre dhe I prishin. Ruajtja e trashëgimisë nënujore është problem dhe në vende të

tjera pasi ka një vlerë të madhe si për historinë ashtu dhe për turizmin. Kërkohet një buxhet I veçantë për këto pasuri, po kur këto lidhen me turizmin sjellin të ardhura të shumta.

Sipas Jim Goold, kryetar i fondacionit amerikan RPM Nautical Archeology, kjo pasuri nënujore është shumë e rëndësishme për të ardhmen e Shqipërisë dhe autoritetet e kanë kuptuar këtë. Përvoja e vendeve si Turqia, Spanja, Italia dëshmon rëndësinë e muzeve me objekte të trashëgimisë nënujore për të ndërtuar dhe mbrojtur identitetin kombëtar.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'

TEL: 045 82 82 82

Osmani: Nuk munda ta refuzoj ofertën e Llapit

Labinot Osmani ka thënë për "Epokën e re" se nuk ka mundur të refuzoj ofertën e Llapit. Ai beson se me këtë skuadër mund të dalë në Evropë, kurse për ndarjen me Vushtrinë "fajtoje" e lë skuadrën e vendlindjes që nuk bëri asnjë projekt për edicionin e ri në elitë



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 16 QERSHOR - Sulmuesi Labinot Osmani është një nga lojtarët më të mirë në dhjetë vjetët e fundit në futbollin e Kosovës, por edhe ndër më të respektuarit. Pavarësisht prej moshës, ai vazhdon të jetë i preferuar nga skuadrat, kurse oferta e Llapit ishte e përfuzueshme dhe "Labi" vendosi të pranojë këtë ofertë. Sulmuesi vushtrias ka thënë të dielën për "Epokën e re" se organizimi i mirë dhe synimet për të fituar trofe janë arsye që ai e zgjodhi skuadrën e Llapit. "Organizimi i mirë i klubit, por edhe projekti i tyre për krijimin e një skuadre konkurruese me ekipet më të mira në vend si dhe ambiciet për fitimin e trofeve dhe dalja në Evropë kanë qenë disa prej arsyeve që kam zgjedhur Llapin", ka thënë Osmani.

Lojtari që ka bërë karrierë në shumë skuadra evropiane, përfshirë edhe Prishtinën dhe Feronikelin në edicionin e fundit, e ka udhëhequr

skuadrën e Vushtrisë drejt rikthimit në IPKO Superligë. Osmani nuk ka hezituar t'i tregojë edhe arsyet pse u largua nga kjo skuadër, ani pse në edicionin edhe Vushtria është pjesë e elitës. "U inkuadruam në Superligë të gjithë së bashku me një punë të jashtëzakonshme duke filluar nga kryesia, stafi teknik, bashkëlojtarët, tifozët 'Forca' dhe gjithë qyteti i Vushtrisë. Unë nuk e braktisa Vushtrinë pasi kam qenë gjithmonë në kontakte me kryesinë e klubit, por kryesia nuk ka bërë diçka rreth organizimit për Superligë, të paktën derisa kam qenë ende pjesë e saj. Pastaj kam pasur shumë oferta të cilat nuk i kam shqyrtuar deri në çastet e fundit për arsye të pritjes së Vushtrisë, sepse është etike të bisedohet me klubin ku kam qenë i lidhur, por që nuk ndodhi ndonjë takim, e në anën tjetër Llapit këmbënguli aq shumë sa nuk munda ta refuzoj ofertën e tij. Falënderoj Vushtrinë për suksesin e arritur së bashku dhe Llapin për interesimin dhe kushtet e ofruara", ka shtuar ai.

Osmani në skuadrën e Llapit do të jetë sërish bashkëlojtar me Mentor Zhdrellën dhe Enis Zaberxhën që ishin ndër më meritoret për arritjen e shpalljes kampionë. Krahas sulmuesve Osmani e Zaberxha, Llapit është përforcuar edhe me Sebino Plakun nga Shqipëria.

Plaku i bashkohet Llapit, largohet Zeqiri

Llapit në fundjavë arriti ta transferojë futbollistin e njohur nga Shqipëria, Sebino Plaku. 34-vjeçari ka një karrierë të bujshme ku është paraqitur për këto skuadra: Apolonia, Dinamo, Skënderbeu, Tirana, Partizani, Flamurtari dhe Kamza, si dhe Ham Kam e Slask jashtë Shqipërisë. Sulmuesi shqiptar do t'i prijë skuadrës që drejtohet nga Tahir Batatina në edicionin 2019/2020. Ndërsa nga skuadra e Llapit pas gjashtë vjetësh është larguar futbollisti Edon Zeqiri, i cila ka vendosur që karrierën të vazhdojë në skuadrën e Flamurtarit nga Prishtina.

SHKURT

Hajdari vazhdon me KB Feronikeli

Klubi i basketbollit Feronikeli konfirmon se ka arritur marrëveshje për vazhdimin e bashkëpunimit edhe për një vit tjetër me basketbollistin Arti Hajdari. Hajdari është edhe reprezentues i Kosovës në basketboll dhe pritet të jetë një nga pikat më të forta të skuadrës nga Drenasi.

Partizani transferon Bledar Hajdinin

Pas William Cordeiro, Partizani ka firmosur me ish-portierin e Përfaqësueses së Kosovës, Bledar Hajdini, i cili ka lindur në Gjermani dhe, së fundmi, ka luajtur në Kosovë me skuadrën e Ballkanit. Hajdini është projektuar si portier i dytë në klubin e kuq, teksa portieri Dashamir Xhika pritet të largohet nga Partizani pas pesë sezonesh.

Sahiti largohet nga Vëllaznimi

Një nga futbollistët me emër më të madh në futbollin e Kosovës, Samir Sahiti, është larguar edhe zyrtarisht nga skuadra e Vëllaznimit. Sahiti nëpërmjet një njoftimi në "Facebook" ka konfirmuar se kontrata i ka përfunduar me skuadrën kuqezi, por nuk e ka përjashtuar mundësinë që edhe në të ardhmen të djersijë fanellën e kësaj skuadre. "Kontrata ime me KF Vëllaznimi ka mbaruar. Faleminderit presidentit Agim Cana për besimin që e kishte tek unë! Faleminderit menaxherit, Besnik Gojanit, që ishte gjithmonë pranë nesh dhe gjithë publikut gjakovar. Po ashtu, faleminderit kryesisë dhe shtabit teknik të bashkëlojtarëve. Jetës nuk i dihet, shihemi prapë", ka shkruar Sahiti.

Bojku përforcon 'Niklin'

Kampioni dhe fituesi i Kupës së Kosovës në futboll, Feronikeli, ka konfirmuar se ka arritur marrëveshje që sezonin e ardhshëm në radhët e klubit të jetë edhe mesfushori Besmir Bojku. Ky i fundit luan disa pozicione në mesfushë dhe në edicionin e fundit realizoi 28 paraqitje, ku realizoi 5 gola dhe dhuroi 5 asistime në Prvs Liga të Maqedonisë si pjesë e Shkëndijës së Tetovës.

Zyrtare: Sarri, trajner i Juventusit

Maurizio Sarri është edhe zyrtarisht trajneri i ri i Juventusit. 60-vjeçari do ta marrë vendin e Massimiliano Allegrit, i shkarkuar në fundin e sezonit të kaluar nga kampionët e Italisë. Sarri pritet të nënshkruajë një kontratë dyvjeçare me bardhezinjtë, me opsion për një vit të tretë. Trajneri Sarri largohet nga "Stamford Bridge" pas një viti ku fitoi Ligën e Evropës dhe siguroi vendin e tretë në Premierë Ligë.

Ndeshja e yjeve përfundoi 4-4

PRISHTINË, 16 QERSHOR - Stadiumi "Fadil Vokrri" është mbushur edhe një herë me tifozë. Kësaj radhe në fushën e këtij stadiumi mitik kanë zbritur dy yjet e futbollit shqiptar, Milot Rashica e Granit Xhaka, që së bashku me shokët e tyre nga bota e sportit e kulturës kanë luajtur kundër njëritjetrit në një ndeshje bamirësie për nder të 20-vje-

torit të çlirimit të Prishtinës. Ndeshja është mbyllur baras, 4:4, derisa tifozët e shumë të janë argëtuar me atë çfarë kanë treguar lojtarët në fushë. Golashënues për ekipin e Milot Rashicës ishin Ermir Lenjani (dy gola) dhe Shefki Kuqi e Milot Rashica, ndërsa golashënues për ekipin e Granit Xhakës ishin Muharrem Sahiti, Dardan Berisha, Granit

Xhaka dhe Armend Thaqi. Ekipi i Xhakës e kishte trajner Afrim Tovërlanin, ndërsa asistent Shpend Ahmetin. Në këtë skuadër, përveç Xhakës, ishin edhe Fatos Sinani, Armend Thaqi, Blerim Rrustemi, Debatik Curri, Arben Zhjeqi, Muharrem Sahiti, Berat Buzhala, Gramos Vokrri, Enis Fetahu, Dukagjin Lipa, Mërgim Mavraj, Ragip Xhaka,

Adrian Berisha dhe Dardan Berisha. Ndërsa trajner i ekipit të Milot Rashicës ishte Ismet Munishi dhe asistent Medën. Në këtë skuadër ishin futbollistët Visar Bekaj, Ermir Lenjani, Milaim Humolli, Armend Dallku, Eroll Salihu, Shefki Kuqi, Ledri Vula,

Suad Keçi, Liridon Leci, Blero Xhevdet Llumnica, Driton Krasniqi, Azem Ahmeti, Mirsad Rashica dhe Haxhi Krasniqi.



Khaka: Krenar që luajta në stadiumin që mban emrin e legjendës Fadil Vokrri

PRISHTINË, 16 QERSHOR - Mesfushori i Arsenalit, Granit Xhaka, ka thënë se ndihet i lumtur dhe krenar që pati rastin të luajë në stadiumin që e mban emrin e legjendës Fadil Vokrri për nder të 20-vjetorit të çlirimit të Prishtinës.

Të shtunën në mbrëmje u zhvillua ndeshja e yjeve, ku ekipi i Granit Xhakës luajti ndaj ekipit të Milot Rashicës. "Nder dhe privilegj kur feston me stadiumin plot 20-vjetorin e çlirimit të Prishtinës, vendlindjes së prindërve të mi. Vërtet isha i emocionuar si kurrë më parë, pasi që po zhvilloja ndeshjen në stadiumin që mban emrin e legjendës 'Fadil Vokrri', po ashtu përkrahja që marr nga Kosova më jep motiv dhe forcë të punoj e ku do që jam të tregoj se nga i kemi rrënjët", ka thënë Xhaka. "Ju falënderoj të gjithëve që ishit të pranishëm! Dashuria dhe përkrahja juaj ma kanë mbushur zemrën duke mos u kursyer asnjëherë që të jem në



mesin tuaj", ka deklaruar Xhaka.


Në ndeshjen që përfundoi 4-4 pjesëmarrës ishin edhe yjet e tjerë të futbollit si Mërgim

Mavraj, Armend Dallku dhe Ermir Lenjani, por edhe ish-futbollistët e njohur si Eroll Salihu, Debatik Curri, Blerim Rrustemi dhe Shefki Kuqi.

Marquezi triumfon në Barcelonë

Barcelonë, 16 qershor - Marc Marquez me Hondan e fitoi garën e Çmimit të Madh të Katalonjës në Moto GP (Barcelonë), suktesi i katërt sezonal për piloton spanjoll. Kjo ka qenë fitorja më e lehtë e kampionit të botës, që përfitoi nga një aksident në xhiron e dytë, ku ngritën "flamurin e bardhë" të gjithë rivalët e tij.

Jorge Lorenzo, shoku i tij i skuadrës, gabon në një kthesë, rrëzohet dhe përfshin në këtë aksident edhe Andrea Dovizioso, Valentino Rossi e Maverick Vinales. Të gjithë ishin duke dueluar mes tyre për fitoren e kësaj gare dhe krejt papritur Marquezi e sheh veten pa rivalë dhe gara përfundon ende pa nisur. Pa presionin e rivalëve, Marquezi e ka të lehtë të fitojë, duke bërë një garë pa presion dhe



duke marrë 25 pikë të lehta, ndërsa rivalët e tij 0 pikë. Spanjoli shkëputet deri në 5 sekonda, duke lënë të hapur garën vetëm për vendin e dytë, ku renditet francezi Fabio Quartararo me Yamaha Petronas. Në podium ngjitet dhe Danilo Petrucci me

Ducati (i treti). Pas kësaj gare, Marquezi shkëputet 37 pikë nga ndjekësi më i afërt në renditjen e botërorit të Moto GP, duke hedhur një hap të rëndësishëm drejt titullin. Gara e radhës, pas dy javësh në pistën e Assen, në Holandë.

SHKURT

Nesta, trajner i ri i Frosinones

Trajneri i ri i skuadrës italiane, Frosinone, që nuk mundi ta mbi-jetonte në Serinë A, do të jetë ish-mbrojtësi legjendar Alessandro Nesta, i cili u preferua "in-extremis" para kandidatit tjetër, Fabio Grosso. Nesta, ish-trajner i Perugias, gjeti gjuhën e përbashkët me shoqërinë e presidentit Stirpe e mund të kthehet nga Miami, ku po kalon pushimet, në orët e ardhshme për ta firmosur kontratën me skuadrën e re. Një goditje e madhe kjo për Frosinonen, që kërkon të ringrihet shumë shpejt me një legjendë në stol mes më të mirave të Serisë A.

Pogba e pranon se do të largohet nga Unitedi

Paul Pogba është përfolur shumë kohët e fundit dhe është lidhur me një kalim të mundshëm te Reali i Madridit. Lidhur me këto zëra nuk ka pasur reagim as nga lojtari dhe as nga klubet respektive, Manchester Unitedi apo Real Madridi. Aktualisht, mesfushori i "Djajve të Kuq" ndodhet në Azi për një tur dhe, së fundmi, duket se ka folur për një gazetar në Tokio. Sipas raportimeve, thuhet se Pogba e ka thënë hapur se kërkon sfida të reja, duke nënkuptuar se koha e tij tek Unitedi ka përfunduar. "Kam tre vjet në Manchester dhe kam kaluar disa çaste të këqija dhe disa të mira, si çdokush kudo. Mendoj se tashmë për mua ka ardhur koha e duhur për sfida të reja", citohet të ketë thënë Pogba.

Arrihet marrëveshja, Hummelsi rikthehet te Dortmundi

Bayern Munchen dhe Borussia Dortmund kanë arritur një marrëveshje për transferimin e ish-kapitenit të verdhezinjve, Mats Hummels, në "Signal Iduna Park", raporton "Bild". Dortmund do të paguajë 20 milionë euro, plus disa bonus që do të bazohen te paraqitja e qendërmbrojtësit gjerman. Gjithashtu, Hummelsi ka pranuar ta ulë rrogën e tij me 2 milionë euro. Te Bayerni fitonte 12 milionë euro, ndërsa te Dortmund do të paguhet 10 milionë. Arsyeja kryesore që ka bindur Hummelsin të kthehet te Dortmund ka qenë garancia për të luajtur më shumë. Gjë që nuk mund ta kishte te Bayerni, veçanërisht pas blerjes së Lucas Hernandezit nga Atletico Madridi.

Lakersat, afër marrëveshjes me Anthony Davis

Anthony Davisit pritet t'i bashkohet LeBron Jamesit te Los Angeles Lakersi. Skuadra kaliforniane e ka bindur New Orleansin duke ofruar Brandon Ingramin, Lonzo Ballin, Josh Hartin si dhe tri zgjedhjet e para, duke përfshirë edhe numrin 4 të këtij viti. Lakersi mposht kështu konkurrencën e Boston Celticsit, që nuk pranon ta lëshojë "xhevahirin" e tyre, Jason Tatum. Me këtë lëvizje, sipas "bookmakers"it, Lakersi bëhet favorit për sezonin e ardhshëm, por gjithsesi merkatoja nuk ka përfunduar. Është po Los Angelesi që dëshiron të nënshkruajë me një tjetër "yll", përveç lojtarëve të rolit, siç është Derrick Favors i Utah Jazzit. Pëlqehet shumë Kyrie Irvingu (është vetëm një hap larg Brooklyn Netsit), por favorit mbetet Kemba Walker. Do të kishte dashur të qëndronte te Charlotte Hornetsi, por ekipi i legjendës, Michael Jordan, nuk i ofron pagën maksimale. Të luash përkrah LeBron Jamesi dhe Anthony Davisit perspektiva bëhet mjaft tërheqëse. Pritet me ankth nëse kampioni i saposhpallur i NBA-s, Kawhi Leonard, do të qëndrojë te Raptorsi, apo Kevin Durant e Klay Thompson, të përndjekur nga dëmtime të rënda, do të largohen nga Golden State Warriors. 4 korriku është ende larg, por poshtë koshit kanë nisur të ndizen fishekzjarrët e merkatos.



NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A. PRISHTINË
GJIP "AUTOBUSKA STANICA" A.D. PRISTINA
MPE "BUS STATION" J.S. PRISTINA

N.P.L. "Stacioni i Autobusëve" SH.A., në bazë të nenin 25 paragrafi 2 pika (h) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, Nr. 03/L-087, ndryshim plotësimin e Ligjit për NP-të Nr.04/L-111 neni 13, Ligjit nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, vendimin e Bordit të Drejtorëve nr.02/919 të datës 13.06.2019, shpall këtë:

K O N K U R S

Pozita e punës: Zyrtar për Auditim të Brendshëm (1 pozitë).

Kohëzgjatja e kontratës: 3 vite, me mundësi vazhdimi.

Orari i punës: I plotë.

Vendi: Prishtinë

Detyrat e përgjithshme:

Bartësi i vendit të punës mbikëqyr dhe koordinon aktivitetet e auditimit, të buxhetit, të hyrave, shpenzimit, prokurimit, depos, stafit dhe aktiviteteve operative që njësiti menaxhuese të ndërmarrjes i realizojnë gjatë aktiviteteve operative në menaxhimin e N.P.L. "Stacioni i Autobusëve" SH.A.

Vlerëson efektivitetin e punës dhe zbatueshmërinë konform me procedurat dhe rregullat e ndërmarrjes.

Bartësi i vendit të punës i raporton Komisionit të Auditimit.

Detyrat specifike dhe përgjegjësitë:

- Aplikon sistemin e kontrollit-auditimit të brendshëm të pranueshëm dhe të efektshëm,
- Të vëzhgojë dhe të kritikoj politikat dhe praktikat jo të mira që kanë të bëjnë me kontabilitet, procedura të ndryshme, administratë, dhe ruajtjen e mjeteve dhe të pasurisë së ndërmarrjes.
- Siguron që aktivitetet e ndërmarrjes të jenë në harmoni me Statutin dhe aktet tjera rregullative, ligjore dhe urdhëresat nga menaxhmenti.
- Monitoron dhe kontrollon zbatimin e vendimeve të Aksionarëve, Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit në linjë me objektivat Planin e Biznesit të ndërmarrjes.
- Kryen kontrollin të brendshme sipas planit të Auditimit të Brendshëm të aprovuar nga Komisioni i Auditimit.
- Diskuton rezultatet e auditimit të kryer me personin përgjegjës të departamentit apo njësisë dhe jep këshilla-udhëzime rreth veprimeve që duhet ndërmarrë për përmirësimin e gjendjes.
- Përpilon raporte të shkruara dhe i'a paraqet për aprovim Komisionit të Auditimit me qëllim të përcjelljes së mëtejshme të tyre tek përgjegjësit e departamenteve apo njësive të audituara.
- Përgatitë raport mujor, vjetor rreth punëve dhe aktiveve të ndërmarrjes.
- Mbledh, analizon dhe vlerëson të dhënat nga fushat e ndryshme të veprimtarisë me qëllim të arritjes së një vlerësimi objektiv
- Analizon praktikën dhe procedurat e kontabilitetit si dhe propozon modifikimin apo përshtatjen e tyre sipas standardeve të kontabilitetit në vend.
- Kryen të gjitha kontrollet dhe auditimet sipas ligjeve në fuqi dhe akteve të brendshme të ndërmarrjes.
- Përveç detyrave dhe përgjegjësisë të cekura, kryen edhe në detyra tjera të kërkuara nga Komisioni i Auditimit dhe Kryeshefi Ekzekutiv.

Kualifikimet dhe aftësitë:

- Të përmbushë kriteret për zyrtarë të ndërmarrjes sipas nenit 13 të Ligjit nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për Ndërmarrjet Publike;
- ZAB duhet të posedojë diplomë universitare nga Fakulteti Ekonomik;
- Të jetë ekspert i certifikuar në kontabilitet si dhe duhet të jetë Auditor i Certifikuar sipas ligjit;
- Duhet të ketë përvojë së paku 3 vjet pune në pozita të larta udhëheqëse apo menaxhuese.
- Njohja e mirë e ligjeve dhe rregulloreve në fuqi, me theks në Ligjin për NP, Ligjin për Shoqëritë Tregtare, si dhe ligjet të tjera që kanë të bëjnë me kontrollin e brendshëm dhe menaxhimin e financave.
- Aftësi të shkëlqyeshme komunikuese
- Njohja e gjuhës angleze në shkrim dhe në folur
- Aftësi organizative dhe koordinuese.
- Preferohet të ketë certifikata të trajnimeve gjatë karrierës.

Dokumentacioni i kërkuar dhe mënyra e aplikimit:

Kandidati/ja, duhet të dorëzojë aplikacionin me dokumente e mëposhtme në pliko të mbyllur në administratën e N.P.L. "Stacioni i Autobusëve" SH.A, Rr. Bill Clinton p.n. në Prishtinë, çdo dite pune nga ora 08:00 deri 16:00 (nga ora 12:00 – 13:00 pauza).

1. Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e SAP <https://www.sap-rks.com/sq/konkurse/>;

2. Një deklaratë nën betim të nënshkruar nga kandidati se i plotëson kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.1 dhe nenit 17.2 (forma mund të shkarkohet nga ueb faqja e Stacionit të Autobusëve <https://www.sap-rks.com/sq/konkurse/>;

3. Letër motivuese;

4. Dëshmi mbi shkollimi;

5. Dëshmi mbi përvojën e punës;

6. Certifikatat e kërkuara;

7. Kopja e letërnjoftimit;

8. Kandidati/ja së bashku me aplikacionin duhet të dorëzojë edhe vërtetimin nga gjykata kompetente se i njëjti nuk është nën hetim – jo më të vjetër se 6 muaj.

Çdo përgjeshtrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

Informata të përgjithshme:

Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjitha qytetarët pa dallim.

Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.

Konkursi është i hapur nga data 17.06.2019 dhe përfundon më datë 16.07.2019 në ora 16:00.



NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A. PRISHTINË
GJIP "AUTOBUSKA STANICA" A.D. PRISTINA
MPE "BUS STATION" J.S. PRISTINA

G.J.P. "Autobuska stanica" A.D. Prishtina, u skladu sa članom 25, stav 2, tačka (h), Zakona o Javnim preduzećima, Br. 03/L-087, te izmenama i dopunama Zakona o JP-a Br. 04/L-111, član 13, Zakona Br. 06/L-21 o Unutrašnjoj Reviziji Javnih Financija, odlukom br. 02/919 usvojenog od strane Upravnog odbora, na dan 13.06.2019 objavljuje sledeći:

K O N K U R S

Radno mesto: Službenik za unutrašnju reviziju (1 pozicija)

Trajanje ugovora: 3 godine, uz mogućnost produženja

Vrsta angažovanja: Puno radno vreme

Lokacija: Prishtina

Opšte dužnosti:

Nosilac radnog mesta nadgleda i koordinira aktivnosti revizije budžeta, prihoda, rashoda, nabavke, skladišta, osoblja i operativnih aktivnosti, koje obavljaju jedinice za upravljanje preduzećem, tokom operativnih aktivnosti i upravljanja NPL "Autobuska stanica" A.D. Prishtina. Procenjuje efikasnost rada i realizaciju, u skladu sa procedurama i pravilima kompanije. Nosilac radnog mesta podnosi izveštaj/e Komitetu za reviziju.

Glavne dužnosti i obaveze:

- Primenjuje prihvatljiv i efikasan sistem interne kontrole i revizije;
- Razmatra i kritikuje loše politike i prakse, koje se odnose na računovodstvo, razne procedure, administraciju i održavanje sredstava i imovine preduzeća;
- Omogućuje da aktivnosti preduzeća budu u skladu sa Statutom i drugim regulatornim, pravnim i upravnim aktima;
- Prati i kontroliše sprovođenje odluka Akcionara, Odbora direktora i Revizione komisije, u skladu sa objektivima Poslovnog plana preduzeća;
- Vrš unutrašnje revizije, u skladu sa Planom interne revizije koji je odobrila Komisija za reviziju;
- Diskutuje o rezultatima revizije sa odgovornom osobom sektora ili jedinice, te pruža savete i smernice o akcijama koje treba poduzeti za poboljšanje situacije;
- Vodi pismene izveštaje i iste dostavlja na odobrenje Komisiji za reviziju, sa ciljem njihovog daljeg dostavljanja kod odgovornih lica sektora ili jedinica pod revizijom;
- Priprema mesečni i godišnji izveštaj o radu i o aktivnostima preduzeća;
- Prikuplja, analizira i procenjuje podatke iz različitih oblasti delovanja, kako bi se došlo do objektivne procene stanja;
- Analizira računovodstvene prakse i procedure, i predlaže njihovu modifikaciju ili prilagođavanje računovodstvenim standardima u zemlji;
- Obavlja sve kontrole i revizije, u skladu sa važećim zakonima i internim aktima preduzeća;
- Osim gorenavedenih obaveza i odgovornosti, obavlja i druge dužnosti koje zahteva Komisija za reviziju i Izvršni direktor preduzeća.

Kvalifikacije i stručna sprema

- Da ispunjava kriterijume za službenike kompanije, u skladu sa članom 13 Zakona Br. 04/L-111 o izmenama i dopunama Zakona o javnim preduzećima;
- SUR treba posedovati univerzitetsku diplomu - Ekonomski fakultet;
- Da je ovlašćeni stručnjak u računovodstvu i ovlašćeni revizor, u skladu sa zakonom;
- Mora imati najmanje 3 godine radnog iskustva na visokim rukovodećim ili upravljačkim pozicijama.
- Dorbo poznavanje zakona i propisa na snazi, sa naglaskom na Zakon o Javnim preduzećima, Zakon o Poslovnim Preduzećima, kao i na ostale zakone koji se bave internom kontrolom i upravljanjem finansijama;
- Odlične sposobnosti u komunikaciji;
- Poznavanje engleskog jezika, u usmenoj i pisanoj formi;
- Organizacione i koordinacione sposobnosti;
- Poželjno je posedovanje certifikata o obuci tokom karijere;

Potrebna dokumentacija i način konkurisanja:

Kandidat mora podneti prijavu sa sledećim dokumentima - u zapečaćenoj koverti - u upravu N.P.L. "Autobuska stanica" A.D. Prishtina; Ul. Bill Clinton bb, u Prishtini - svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 (pauza 12:00-13:00 sati).

1. Aplikacija za zapošljenje se mo že peuzeti sa SAP veb-stranice:

<https://www.sap-rks.com/sq/konkurse/>

2. Izjava pod zakletvom - potpisana od strane kandidata, koja potvrđuje da kadidat ispunjava kriterijume nezavisnosti, prema članovima 17.1 i 17.2 .

Obrazac se može preuzeti sa veb-stranice Autobuske stanice:

<https://www.sap-rks.com/sq/konkurse/>

3. Motivaciono pismo;

4. Dokazi o obrazovanju;

5. Dokaz o radnom iskustvu;

6. Potrebni sertifikati;

7. Kopija lične karte;

8. Zajedno sa prijavom kandidat mora dostaviti i potvrdu od nadležnog suda da isti nije pod istragom - ne starijom od 6 meseci.

Svako opovrgavanje materijala - bilo namerno ili usled nemarnosti, ili zamena materijala u poredjenju sa informacijama navedenim u pomenutoj izjavi, rezultiraće trenutnom diskvalifikacijom kandidata.

Opšte informacije:

Pravo konkurisanja imaju svi građani, bez razlike;

Preduzeće pruža jednake mogućnosti, te podstiče i promovise angažovanje radnika, koji mogu biti pripadnici svih zajednica i različitih polova.

Konkurs je otvoren od 17.06.2019, i završava se 16.07.2019 u 16:00 sati.



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu, 60000, Gjiilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Rektori: Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi

Ref. nr.01/ 1039 14/06/2019

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës, Nr. 03/L-212, dispozitat e nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës, Nr. 04/L-037, si dhe nenit 48, paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit "Kadri Zeka" Gjiilan, Senati i Universitetit në mbledhjen XXXI, të mbajtur më datë 06.06.2019, merr vendim për të shpallur:

K O N K U R S

Për zgjedhjen/rizgjedhjen e personelit të rregullt akademik në njësitë akademike të Universitetit "Kadri Zeka" Gjiilan, për vitin akademik 2019/2020.

Fakulteti i Edukimit

1. Një mësimdhënës për lëndët: Gjuhë angleze I dhe II, Gjuhë angleze për mësues me plotësim norme në Fakultetin Juridik në lëndët Gjuhë Angleze I dhe II.

Fakulteti Ekonomik

2. Një mësimdhënës për lëndët: Hyrje në Mikroekonomi, Hyrje në Makroekonomi, Tregjet dhe Institucionet Financiare, Qeverisje korporative, Menaxhimi i riskut dhe sigurimit.
3. Një mësimdhënës për lëndët: Hyrje në Mikroekonomi, Hyrje në Makroekonomi, Bankat dhe afarizmi bankar, Financat korporative, analiza e investimeve, Menaxhmenti bankar.
4. Një mësimdhënës për lëndët: Financa, Financa nderkombetare, Menaxhimi i investimeve, Auditimi, Ekonomia e Kosovës dhe BE-se, Teoria dhe politika monetare.

Fakulteti Juridik

5. Një mësimdhënës për grup lëndësh nga fusha: juridike – penale.

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike

6. Një mësimdhënës për lëndët: Matematikë për informatikë I dhe II me plotësim norme në Fakultetin e Edukimit në lëndët: Metodologji e mësimit të matematikës I në programet Fillor dhe Parashkollor.

Kandidatët të cilët paraqiten në konkurs duhet t'i dorëzojnë këto dokumente:

- Kërkesën;
- Biografinë (CV) ;
- Kopjen e diplomës të studimeve themelore, masterit dhe doktoraturës, të noterizuara;
- Certifikatën e notave në tri nivelet e studimit;
- Certifikatën e lindjes;
- Certifikatën e shtetësisë (ose certifikatën për vendbanimin në Republikën e Kosovës) ;
- Dëshmi (kopjet) për punimet shkencore, monografive, teksteve mësimore, publikime në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike, pjesëmarrje aktive në konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare etj.
- Dëshmi për përvojën e punës në mësimdhënie dhe profesione tjera lidhur me fushën e mësimdhënies në arsimin e lartë;
- Çertifikatë nga gjykata, se ndaj tij nuk janë duke u zhvilluar hetime;
- Dëshmi për njohjen e gjuhës së huaj botërore.

Kandidatët që kanë doktoruar ose kanë përfunduar studimet baçelor apo master jashtë vendit duhet të sjellin dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse nga MASHT-i .

Kandidatët duhet të sjellin njërin prej këtyre dokumenteve si dëshmi për njohjen e gjuhës së huaj botërore:

1. Të kenë të kryer njërin nivel të studimeve në gjuhën e huaj ose certifikatë IELTS, TOEFL apo ndonjë dokument tjetër të vlefshëm.

Kandidatët duhet t'i plotësojnë të gjitha kushtet e parapara me Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr.04/L-037, Statutin e Përkohshëm të Universitetit "Kadri Zeka" Gjiilan, në veçanti ato që parashihen në nenin 155,156 dhe 157 të këtij Statuti (shih: <http://uni-gjilan.net/dokumente-relevante/>) dhe Rregulloreve në fuqi për zgjedhjen e personelit akademik në UKZ.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit në gazetë.

Paraqitja e dokumenteve: Kërkesa protokolohehet në zyrën nr.4, kurse i tërë dokumentacioni dorëzohet në zyrën për çështje akademike, nr. 3.

Aplikantët duhet të plotësojnë formularin P1 të cilin mund t'a shkarkojnë nga ueb- faqja e universitetit, dhe në mënyrë elektronike e dërgojnë në info@uni-gjilan.net kurse dokumentet e tjera dërgohen në kopje fizike.

Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në ueb faqen zyrtare të universitetit:

<http://www.uni-gjilan.net>

Kërkesa për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Vëllezërit Frashëri"

Komuna: Skenderaj

Data: 17.06.2019

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/121-CS/1.3	Trajnim: Gjithëpërfshirja

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shfmu "Vëllezërit Frashëri", Qubrel, Skenderaj.

Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme: Trajnim: Gjithëpërfshirja

Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe personelin e shkollës
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme.

Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e Gjithëpërfshirjes (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).

Firmat Konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën : **Shfmu "Vëllezërit Frashëri", Qubrel, Skenderaj më së largu deri më datën; 25.06.2019**

Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: **Florim Rrustemi**

Telefoni: **044/194-633**

E-maili: **florimrrustemi@live.com**

Kërkesa për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Kuvendi i Drenicës"

Komuna: Skenderaj

Data: 17.06.2019

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/116-CS/1.4	Trajnim: Puna e Kujdestarit të klasës – kujdestari i mirë

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shfmu "Kuvendi i Drenicës" Abri e Poshtme, Skenderaj. Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme: Trajnim: Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie

Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme.
- Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe personelin e shkollës
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e përdorimit të teknologjisë;

Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e menaxhimit, monitorimit, cilësisë (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).Firmat Konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën: **Shfmu "Kuvendi i Drenicës" Abri e Poshtme, Skenderaj, më së largu deri më datën; 25.06.2019** Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: **Smajl Behramaj**

Telefoni: **044/164-131**

E-maili: **smajl_behramaj@hotmail.com**



BeyAb for bread

Risi, tani BEYAB-in mund ta gjeni edhe nëpër dyqanet e Kosovës. BeyAb është prodhim turk, dhe përpos tregut në Shqipëri e Mal të Zi tani edhe në Kosovë.



RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553
Prishtinë

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

Lume's Details

Estetik & Depilim



044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Mirlinda Sopjani shpallë të pavlefshme diplomën e shkollës SH.M.M. "Shtjefan Gjeqovi" Prishtinë me nr. 214. e lëshuar në vitin 2006.

► Endrit Hamza shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI IX shf "Avdyl Frasheri " Prizren

► Rahime Shala shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Dy Dëshmorët " Piranë

► Idriz Bytywi shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Dy Dëshmorët " Piranë

► Festim Saliu shpall të pavlefshme diplomën shme "Ymer Prizreni" Prizren

► Dr. Alban Hasani, Urolog nga Prizreni shpallë të pavlefshme certifikatën e Licencës së mjekut të përgjithshëm me nr. KO-04672-01.

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi 52 000€. Për info 044/672-439.

► Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irno 044/672-439.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

PA LIMIT MIN & SMS 3GB



4.99€

*Pako përmban edhe 300 minuta me operatorë tjerë në Kosovë.



Pakot mujore të Ofertës më të mirë n'botë përmbajnë benefite të kombinuara si minuta PA LIMIT brenda rrjetit, minuta me operatorë tjerë, SMS PA LIMIT drejt të gjithë operatoreve dhe internet në mobil.

IDEALE

MIN&SMS PA LIMIT
+300 MIN
DREJT OPERATORVE TJERË
3GB

4.99€

PLUS

MIN&SMS PA LIMIT
+500 MIN
DREJT OPERATORVE TJERË
5GB

6.99€

TOP

MIN&SMS PA LIMIT
+700 MIN
DREJT OPERATORVE TJERË
10GB

12.99€

FANTASTIK

MIN&SMS PA LIMIT
+1000 MIN
DREJT OPERATORVE TJERË
20GB

17.99€

*Pasi që shpenzoni minutat me operatorë tjerë, çmimi për minutë është vetëm 5 cent.

Balancin e benefiteve e kontrolloni duke thirrur *123#

Vizitoni pikën më të afërt të IPKO-së për të marrë njëren nga këto pako.

WWW.IPKO.COM

